VENDIM
Nr. 78, datë 12.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 28.9.2017 dhe 2.10.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 31 Akti, që u përket:

KËRKUES: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga kryetari i saj, z. Erjon Bani.

Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga z. Genti Dokollari, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga znj. Vasilika Hysi dhe znj. Yllka Banushi, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 7, pika 2, shkronjat "a" dhe "c"; nenit 59, pika 1, shprehja "*zëvendëskryetari*"; nenit 62, pika 8, shprehja "*2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar*" dhe pika 13, shprehja "*2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar*"; nenit 68, pika 6; nenit 76, pika 2; nenit 157, pika 1, shprehja "*zëvendëskryetari*"; nenit 160, pika 8, shprehja "*2 anëtarë joprokurorë*" dhe pika 13, shprehja "*2 anëtarë joprokurorë dhe 1 anëtar prokuror*"; nenit 166, pika 6; nenit 175, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

2. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 12, pika 2, shkronjat "b" dhe "c"; nenit 42, pika 3, shkronjat "a", "b", "c", "ç", dhe pikat 8 e 9 të tij; nenit 43; nenit 47, pika 2, shkronja "a", shprehja "*...nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale...*" dhe shkronja "b", shprehja "*...nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale...*", pika 4, shprehja "*...nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë...*", dhe pika 5, shprehja "*nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë*"; nenit 53, pikat 11 dhe 12, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

3. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 4, pika 2, shprehja "*ose në vlerësimin tërësor të procedurave*"; nenit 36, pika 3, shprehja "*ose për personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar për qëllim të këtij ligji*"; nenit 37, shkronjat "b", "c" dhe "ç"; nenit 38, pika 1, shprehja "*në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme*", pika 4, shkronja "b", shprehja "*ose personi i lidhur me të*", shkronja "c", shprehja "*ose një person i lidhur me të*" dhe shkronja "d", fjalia e dytë me përmbajtje "*Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës*"; nenit 39, pika 1, shprehja "*ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar*"; neni 49, pika 1, shkronja "ç" dhe pika 2; nenit 54; nenit 56, pika 1, shprehja "*jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji*"; nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 7, 15, 17, 18, 32, 35, 36, 42, 49, 78, 116, 124, 125, 131/a, 134/h, 138, 145, 147, 148, 149 dhe 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet A-G të Aneksit të saj; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 49, pikat 3/d e 4, dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, përfaqësuesit e kërkuesve, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) ka miratuar ligjin nr. 76/2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"". Pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi ka miratuar edhe:

1.1 Ligjin nr. 84/2016, datë 30.8.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit, të parimeve të organizimit të procesit të rivlerësimit, të metodologjisë, të procedurave dhe të standardeve të rivlerësimit, si dhe organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit.

1.2 Ligjin nr. 96/2016, datë 6.10.2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", objekti i të cilit është përcaktimi i statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre, pranimin dhe emërimin, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe profesional, si edhe përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile.

1.3 Ligjin nr. 115/2016, datë 3.11.2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", objekt i të cilit është përcaktimi i parimeve dhe rregullave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*), të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*ILD*), të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (*KED*), si dhe të Shkollës së Magjistraturës.

2. Të tria ligjet e mësipërme, në tërësinë ose dispozitat e veçanta të tyre, janë kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), e cila është shprehur me vendimet nr. 2, datë 18.1.2017 (për ligjin nr. 84/2016), nr. 34, datë 10.4.2017 (për ligjin nr. 96/2016) dhe nr. 41, datë 16.5.2017 (për ligjin nr. 115/2016).

3. Me kërkesën e datës 26.5.2017, kërkuesit i janë drejtuar sërish Gjykatës për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të disa dispozitave të ligjeve të mësipërme.

II

4. Kërkuesit, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë (SHKGJRSH) dhe Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë (UGJSH), në mënyrë të përmbledhur kanë paraqitur këto shkaqe në mbështetje të pretendimeve të tyre:

i) Për legjitimimin e kërkuesve

4.1 SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 8577/2000*), legjitimohen *ratione personae* për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, pasi janë organizata të regjistruara si persona juridikë me vendim të gjykatës. Bazuar në parashikimet e statuteve të shoqatave kërkuese, për sa i takon qëllimit të krijimit dhe objektit të veprimtarisë, si edhe në faktin se dispozitat e ligjeve objekt kundërshtimi, duke cenuar një sërë parimesh e standardesh kushtetuese, ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e tyre, vlerësohet se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet veprimtarisë ligjore dhe çështjes kushtetuese së ngritur, ndaj ata legjitimohen edhe *ratione materia*. Për sa i takon legjitimimit *ratione temporis*, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 50 të ligjit organik të Gjykatës.

ii) Për themelin e kërkesës

4.2 Për kundërshtimin e ligjit nr. 115/2016

4.2.1 Është cenuar parimi i hierarkisë së akteve ligjore dhe i shtetit të së drejtës:

4.2.1.1 Kriteret e parashikuara në nenin 7, pika 2, shkronjat "a" dhe "c", që duhet të plotësojnë kandidatët gjyqtarë për t'u zgjedhur si anëtarë të KLGJ-së, bien ndesh me nenin 147 të Kushtetutës, pasi tejkalojnë përmbajtjen e tij. Dispozita kushtetuese ka përcaktuar kriterin 15 vjet përvojë pune në profesion për anëtarët jogjyqtarë të KLGJ-së, ndërkohë jo pa kuptim ka heshtur në lidhje me kriterin vjetërsi në profesion për anëtarët gjyqtarë të këtij organi. Gjithashtu, vendosja e kriterit të vlerësimeve profesionale përkthehet në përcaktimin e një afati kohor karriere për gjyqtarin, përpara se ai të ketë të drejtë të kandidojë si anëtar i KLGJ-së.

4.2.1.2 Në nenet 59, pika 1, dhe 157, pika 1, të ligjit është parashikuar pozicioni i zëvendëskryetarit të KLGJ-së dhe KLP-së dhe kushtëzimi që ai të zgjidhet nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë apo joprokurorë, çka bie ndesh me nenet 147, pika 9 dhe 149, pika 9 të Kushtetutës. Me anë të përmbajtjes së kësaj dispozite ligjvënësi ka dobësuar rolin e anëtarëve gjyqtarë në KLGJ dhe atyre prokurorë në KLP.

4.2.1.3 Nga përmbajtja e nenit 62, pikat 8 dhe 13, të ligjit rezulton se Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit përbëhet nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar, ndërsa për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të ILD-së për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Përbërja e këtyre komisioneve me shumicë jogjyqtarë bie në kundërshtim me nenin 147 të Kushtetutës, i cili parashikon se KLGJ-ja vepron me shumicë gjyqtarësh, raport që duhet të ruhet edhe në komisionet e përhershme e të përkohshme. Të njëjtat argumente vlejnë edhe për nenin 160, pikat 8 dhe 13, parashikime të cilat bien në kundërshtim me nenin 149 të Kushtetutës.

4.2.1.4 Sipas nenit 68, pika 6, kur KLGJ-ja nuk funksionon në mënyrë të plotë, pasi një anëtar mund të mos marrë pjesë në mbledhjen plenare për arsye papajtueshmërie, dhe për pasojë ka barazi të votave, vota e kryetarit, i cili është gjithmonë anëtar jogjyqtar, ka përparësi, çka bën që KLGJ-ja për çështje të cilat janë përcaktuese për statusin e gjyqtarëve t'i marrë vendimet nga anëtarët e saj jogjyqtarë. Të njëjtat argumente vlejnë edhe për nenin 166, pika 6, të këtij ligji.

4.2.1.5 Neni 76, pika 2, i ligjit ia ka lënë kompetencën për të vendosur përjashtimin e një anëtari të organit kolegjial një organi monokratik, sikurse është kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët jogjyqtarë, çka bën që kryetari të jetë përcaktues në përbërjen e shumicës së KLGJ-së. Të njëjtat argumente vlejnë edhe për nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 115/2016.

4.2.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e karrierës:

4.2.2.1 Neni 68, pika 6, i ligjit cenon parimin e sigurisë juridike, pasi ka përkeqësuar të drejtat dhe garancitë e statusit të gjyqtarit. Përmbajtja e tij nuk respekton parimin e kolegjialitetit në vendimmarrjet e KLGJ-së, si dhe cenon parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarit.

4.2.3 Është cenuar parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve:

4.2.3.1 Parashikimet e nenit 62, pikat 8 dhe 13, bien ndesh edhe me këtë parim, pasi prania e anëtarëve jogjyqtarë në KLGJ nuk mund të ketë rol përcaktues, sepse qeverisja e gjyqësorit i është lënë si rregull shumicës, e cila duhet të vijë nga radhët e gjyqtarëve. Të njëjtat argumente vlejnë edhe për nenin 160, pikat 8 dhe 13 të ligjit.

4.2.3.2 Parashikimi i nenit 68, pika 6, bën që vendimet në mbledhjen plenare të merren nga anëtarët jogjyqtarë, për pasojë nuk ka më vetëqeverisje, por kontroll të plotë të pushtetit gjyqësor nga ai legjislativ. Në kuptim të këtij parimi edhe kompetenca për përjashtimin e anëtarit, e parashikuar në nenin 76, pika 2, duhet të jetë ekskluzive e mbledhjes plenare, pasi mjafton që kryetari në mënyrë abuzive të pranojë kërkesa të tilla dhe KLGJ-ja vendoset nën kontrollin e plotë të dy pushteteve të tjera. Këto argumente vlejnë edhe për nenin 166, pika 6, dhe nenin 175, pika 2, të këtij ligji.

4.2.4 Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë:

4.2.4.1 Neni 68, pika 6, cenon parimin e prezumimit të pafajësisë, sepse barazia e votave në një procedim disiplinor ndaj gjyqtarit duhet të shkojë në favor të tij, pasi në këtë rast si fakti, ashtu edhe fajësia janë të dyshimta. Veçanërisht kjo është e dyshimtë atëherë kur vota e kryetarit, e cila prevalon në rast barazie, është në disfavor të gjyqtarit.

4.2.5 Është cenuar e drejta për punë dhe parimi i barazisë para ligjit:

4.2.5.1 Përmbajtja e nenit 7, pika 2, shkronjat "a" dhe "c", bën që të cenohet edhe e drejta për të zgjedhur një vend pune, për të konkurruar dhe për t'u zgjedhur anëtar i KLGJ-së, pasi Kushtetuta nuk e ka kushtëzuar të drejtën për të konkurruar me ndonjë afat, por thjesht me pjesëmarrjen proporcionale sipas shkallëve të gjykimit dhe nuk e lidh me pasjen e një vjetërsie në punë. Parashikimi në nenet 59, pika 1, dhe 157, pika 1, që ndalon anëtarët gjyqtarë dhe prokurorë që të konkurrojnë për vendin e zëvendëskryetarit të organeve kushtetuese, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme, bie ndesh me nenet 49 dhe 18 të Kushtetutës, pasi ata diskriminohen në raport me anëtarët e tjerë, pa pasur asnjë arsye objektive dhe të përligjur për të bërë një gjë të tillë.

4.3 Për kundërshtimin e ligjit nr. 96/2016

4.3.1 Është cenuar parimi i shtetit të së drejtës dhe e drejta e karrierës:

4.3.1.1 Neni 42, pikat 3, 4, 8 dhe 9, dhe neni 43 pengojnë gjyqtarët e shkallës së parë që pasi të kenë plotësuar kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 47 i ligjit, të kenë mundësi të paraqesin kërkesë për të kandiduar si gjyqtarë pranë gjykatave të apelit, çka do të përbënte edhe karrierën normale dhe të zakonshme të çdo gjyqtari. Sipas parashikimit të vendosur nga këto dispozita, vendet e lira që krijohen në çdo gjykatë apeli mund të plotësohen vetëm me anë të lëvizjes paralele nga gjyqtarët e tjerë të gjykatave të apelit. Madje këto parashikime, përveçse diskriminojnë gjyqtarët e shkallës së parë, përkeqësojnë statusin dhe karrierën e tyre. Nenet 42 dhe 43 parashikojnë për herë të parë një rregullim ligjor që nuk ka qenë i parashikuar më parë në asnjë prej legjislacioneve që kanë rregulluar statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Ato krijojnë një institut të huaj për pushtetin gjyqësor që është "procedura e lëvizjes paralele", e cila pengon në mënyrë jokushtetuese karrierën profesionale ose ngritjen në detyrë të gjyqtarëve.

4.3.1.2 Të njëjtat argumente vlejnë edhe për përmbajtjen e nenit 47, pikat 2, 4 dhe 5, ku parashikohen ndalime joproporcionale që cenojnë të drejtën e karrierës si një element i statusit të gjyqtarit, e garantuar nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha garancitë kushtetuese që mbron ky nen, si palëvizshmëria, mbrojtja e pagës, si dhe përfitimet e tjera janë në funksion të pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i tyre krijon edhe besimin te publiku për sa i përket pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve. Për rrjedhojë, është cenuar edhe parimi i sigurisë juridike në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme, si dhe besueshmërisë së qytetarëve te shteti.

4.3.1.3 Neni 53, pikat 11 dhe 12, krijon dyshime për devijim nga rregullat kushtetuese të procedimit disiplinor. Sipas nenit 147/a të Kushtetutës përgjegjës për vendosjen e masave disiplinore të gjyqtarëve është vetëm KLGJ-ja, kurse për prokurorët, sipas nenit 149/a, është KLP-ja. Po ashtu, sipas nenit 147/d të Kushtetutës ILD-ja është përgjegjëse për hetimin dhe fillimin e procedimit disiplinor. Në kundërshtim me këto parashikime, dispozitat e kundërshtuara ia kanë lënë procedimin disiplinor të magjistratit të komanduar organeve të pushtetit ekzekutiv, legjislativ apo edhe gjyqësor, në të cilat ai është komanduar, por që janë të ndryshme nga sa përcakton Kushtetuta.

4.3.2 Është cenuar e drejta për punë dhe parimi i barazisë para ligjit:

4.3.2.1 Neni 12, pika 2, shkronja "b", në pjesën e fundit të fjalisë nuk u garanton gjyqtarëve trajtim sipas vendit të punës, njësoj me prokurorinë e së njëjtës shkallë dhe me të njëjtin funksion. Ky parashikim bie në kundërshtim edhe me nenin 18 të Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e barazisë para ligjit, si dhe me nenin 17/1 të saj, sepse kufizon, jo për interes publik dhe në mënyrë joproporcionale, pagën e magjistratëve që ushtrojnë funksionin në gjykatën e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar shkalla e parë. Sipas dispozitës të kundërshtuar, paga e

magjistratëve që ushtrojnë funksionin në gjykatën e posaçme kualifikohet në grupin G2, kurse paga e magjistratëve që ushtrojnë funksionin e prokurorit pranë së njëjtës gjykatë, si pjesë e Prokurorisë së Posaçme, kualifikohet në grupin G3, sipas shkronjës "c" të këtij neni, çka krijon një situatë paradoksale, pasi prokurori përfiton një pagë më të madhe se vetë gjyqtari i gjykatës pranë së cilës ai ushtron funksionin. Kjo përbën diskriminim të gjyqtarëve përballë prokurorëve, pasi këta magjistratë edhe pse ndodhen në të njëjtën shkallë të sistemit, paguhen me paga të ndryshme.

4.3.2.2 Edhe nenet 42, pikat 3, 4, 8 dhe 9; 43; 47, pikat 2, 4 dhe 5, duke vendosur ndalime disproporcionale për të kandiduar për gjyqtarin e shkallës së parë, cenojnë në thelb të drejtën për të zgjedhur vendin e punës sipas sistemit të kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme.

4.4 Për kundërshtimin e ligjit nr. 84/2016

4.4.1 Është cenuar parimi i shtetit të së drejtës dhe i hierarkisë së akteve ligjore:

4.4.1.1 Sipas neneve 36, pika 3, 38, shkronja "d", dhe 39, pika 1, në kundërshtim me nenin DH, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, grupi i punës e shtrin hetimin edhe te personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar, të cilët prezumohen të pafajshëm derisa të deklarohen fajtorë me vendim të formës së prerë. Kjo bën që të ulen garancitë kushtetuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke i akuzuar për kontakte të papërshtatshme me persona që thjesht dyshohen se janë pjesë e krimit të organizuar. Vlerësimi nëse subjekti i rivlerësimit ka tendenca kriminale dhe nëse mund të vihet nën presion nga struktura kriminale nuk është objekt i vlerësimit të figurës dhe është në tejkalim të Kushtetutës. Për pasojë cenohet parimi i hierarkisë së akteve ligjore.

4.4.1.2 Gjithashtu, neni DH, pika 1, i Aneksit të Kushtetutës parashikon se objekti i kontrollit të figurës shtrihet nga data 1 janar 2012, ndërkohë që në deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, dhe në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk evidentohet se cila do të jetë periudha e vlerësimit.

4.4.1.3 Në kundërshtim me nenin DH, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës kontrolli shtrihet, sipas nenit 38, pika 4, shkronjat "b" dhe "c", edhe ndaj personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Qëllimi i procesit të vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve është identifikimi i kontakteve të papërshtatshme me krimin e organizuar të subjektit të deklarimit dhe jo të personave të lidhur me të. Përgjegjësia është individuale dhe nuk mundet kurrsesi që një subjekt i deklarimit të shkarkohet nga detyra se një person i lidhur me të ka mbajtur kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar. Edhe deklarata për kontrollin e figurës, në pjesën që detyron subjektin e deklarimit të deklarojë kontakte të papërshtatshme të personave të lidhur me të, është jo vetëm jashtë objektit të vlerësimit kalimtar, por bie ndesh edhe me nenin 32 të Kushtetutës.

4.4.1.4 Sipas nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës rivlerësimi bëhet vetëm mbi 3 komponentë: kontrolli i pasurisë, i figurës dhe i aftësive profesionale. Po ashtu, hetimi, gjykimi, marrja dhe administrimi i provave dhe vlerësimi i tyre nga KPK-ja dhe KA-ja duhet të përqendrohen vetëm mbi këta komponentë. Për pasojë, nenet 49, pika 2, dhe 54 të ligjit dalin tej objektit të vlerësimit të këtyre organeve dhe marrja e administrimi si provë i deklaratës së dhënë para prokurorit nuk ka asnjë vlerë për procesin e rivlerësimit kalimtar, pasi nuk mund të provojë asnjë nga komponentët e tij.

4.4.1.5 Ligji nr. 84/2016 ka parashikuar si një nga shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit edhe vlerësimin tërësor të procedurave, sipas neneve 4, pika 2, dhe 61, pika 5, të cilat bien në kundërshtim me nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës, pasi shtojnë një kriter tjetër përveç atyre të parashikuara nga dispozita kushtetuese.

4.4.1.6 Ky parim cenohet edhe nga neni 56 i ligjit, i cili vjen në kundërshtim me nenin G të Aneksit të Kushtetutës. Dispozita kushtetuese ka parashikuar mundësinë e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, por nuk ka caktuar afat kohor për këtë qëllim, ndërkohë që neni 56 ka përcaktuar një afat 3-mujor, duke dalë tej parashikimit kushtetues.

4.4.2 Është cenuar parimi i ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve:

4.4.2.1 Marrja, administrimi dhe çmuarja nga KPK-ja dhe KA-ja i deklaratës së dhënë nga i ashtuquajturi "bashkëpunëtori i drejtësisë", sipas nenit 54 të ligjit, cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, pasi gjykimi i çështjeve penale është në kompetencë të Gjykatës për Krimet e Rënda.

4.4.2.2 Ky parim cenohet edhe nga neni 37, shkronja "ç", i ligjit, pasi hipoteza për të vepruar vetëm pa asnjë lloj forme bashkëpunimi në krimin e organizuar nuk ka asnjë sens logjik dhe juridik. Për më tepër, kjo është detyrë e mirëfilltë e një procedimi penal dhe hetimi është kompetencë kushtetuese e organit të prokurorisë, ndërsa gjykimi është kompetencë e Gjykatës për Krimet e Rënda.

4.4.3 Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

4.4.3.1 Marrja, administrimi dhe çmuarja nga KPK-ja dhe KA-ja i deklaratës së dhënë nga i ashtuquajturi "bashkëpunëtori i drejtësisë", sipas nenit 54 të ligjit, cenon parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi gjykimi i çështjeve penale është në kompetencë të Gjykatës për Krimet e Rënda.

4.4.3.2 Sipas neneve 3, pika 6, dhe 38 të ligjit kontrolli i figurës do të provohet nga përgjimet e komunikimeve telefonike, nga informacionet konfidenciale dhe nga informacionet e tjera të disponueshme. Sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale përgjimi i komunikimeve elektronike bëhet vetëm me vendim gjykate në kuadrin e një procesi penal dhe rezultatet e përgjimit parandalues nuk përdoren si provë. Për sa kohë që ato nuk mund të përdoren si provë në një proces penal, nuk ka sens logjik dhe juridik që të përdoren si provë, për më tepër me fuqi prapavepruese, për procese të natyrës administrative-disiplinore. Në këtë mënyrë cenohet e drejta për t'u gjykuar në bazë të provave të mbledhura në mënyrë të ligjshme.

4.4.3.3 Nenet 38 dhe 39 të ligjit cenojnë të drejtën për mbrojtje efektive dhe parimin e barazisë së armëve. Subjektet e rivlerësimit e kanë të pamundur për t'u ballafaquar me informacionet konfidenciale dhe personat që i japin këto informacione. Ndodhur në këto kushte, duke qenë se në thelb procedimi disiplinor i gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të rivlerësimit kalimtar është i ngjashëm me një procedim penal, sipas parimeve të procesit të rregullt askush nuk mund të akuzohet dhe të dënohet/shkarkohet duke u bazuar në një dëshmitar të vetëm dhe asnjë provë nuk mund të ketë vlerë të paracaktuar, por duhet të vlerësohet në unitet me provat e tjera, të cilat duhet të debatohen në respektim të parimit të kontradiktoritetit.

4.4.4 Është cenuar e drejta për jetë private dhe familjare:

4.4.4.1 Neni 3, pika 6, synon ta provojë kontaktin e papërshtatshëm në kuadrin e kontrollit të figurës nëpërmjet përgjimeve të komunikimeve elektronike. Në kushtet kur këto komunikime nuk kanë mbikëqyrjen e gjykatës, ato nuk mund të përdoren si provë para KPK-së dhe KA-së, pasi jo vetëm që merren në mënyrë të paligjshme, por nuk respektojnë as të drejtën për një jetë private sipas nenit 8 të KEDNJ-së.

4.4.4.2 Nenit 49, pika 1, shkronja "ç", i mungon qartësia dhe kriteret se kur vendoset kontrolli i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe se cila është gjykata kompetente. Në mungesë të kritereve të qarta e të përcaktuara ekziston mundësia e abuzimit nga organet e rivlerësimit, duke cenuar në këtë rast si parimin e sigurisë juridike, ashtu dhe të drejtën e respektimit të jetës private.

5. *Subjekti i interesuar, Kuvendi*, ka prapësuar para Gjykatës sa vijon:

i) Për legjitimimin e kërkuesve

5.1 Kërkuesit nuk legjitimohen në kërkesën e tyre, sepse kanë zgjedhur për t'u përfaqësuar në Gjykatën Kushtetuese nga një avokat, i cili nuk plotëson kushtet ligjore për përfaqësim, pasi sipas shkresës nr. 303, datë 19.6.2017 të Dhomës Kombëtare të Avokatisë nuk rezulton të jetë në listën e avokatëve që mund të ushtrojnë profesionin përpara Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, sipas statutit të Shoqatës së Gjyqtarëve është këshilli drejtues, i cili vendos për kundërshtimin e akteve normative në Gjykatën Kushtetuese dhe në rastin konkret nuk rezulton të ketë një vendim nga ky këshill. Ndërsa

në statutin e Unionit të Gjyqtarëve nuk ka asnjë dispozitë, e cila i jep të drejtë ndonjë organi të kësaj shoqate që të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Kërkuesve u mungon legjitimiteti edhe për sa i përket kundërshtimit të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me KLP-në, pasi sipas statuteve të të dyja shoqatave, anëtarët e tyre janë gjyqtarë, ndaj ato mund të bëjnë kërkesë vetëm për dispozitat që kanë të bëjnë me gjyqtarët dhe jo me prokurorët.

ii) Për parimin e gjësë së gjykuar (res judicata)

5.2 Të gjitha nenet e ligjit nr. 96/2016 objekt kërkese, përveç nenit 12, shkronja "c", dhe nenit 53, pikat 11 e 12, janë trajtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese, e cila është shprehur me vendimin nr. 34, datë 10.4.2017, ndaj pretendimet lidhur me to duhen rrëzuar sipas parimit *res judicata*.

5.3 Edhe ligji nr. 84/2016 ka qenë më parë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese. Me vendimin nr. 2, datë 18.1.2017 Gjykata rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e këtij ligji, duke argumentuar se nuk ka cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve (paragrafët 16–48), parimit të sigurisë juridike (paragrafët 49–68), të të drejtave themelore të njeriut (paragrafët 59–70) dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (paragrafët 71–78). Për rrjedhojë, bazuar në parimin e gjësë së gjykuar, kërkesa për shfuqizimin e disa neneve të këtij ligji duhet të rrëzohet.

iii) Për themelin e kërkesës

5.4 Për dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 115/2016

5.4.1 Në lidhje me pretendimet për nenin 7, pika 2, të ligjit, Kushtetuta në nenin 147, pika 3, të saj përcakton në mënyrë të qartë se ligji mund të shtojë më shumë kritere për anëtarët e KLGJ-së sesa ato të parashikuara në Kushtetutë. Vjetërsia si gjyqtar është qartësisht një kriter i tillë. Është detyrë e ligjvënësit të gjejë një mënyrë praktike për të zbatuar këtë parashikim të qartë dhe të drejtpërdrejtë kushtetues. Ky është pikërisht qëllimi dhe dobia e kërkesës që gjyqtarët të cilët kandidojnë për detyrën e anëtarëve të KLGJ-së duhet të vlerësohen "shumë mirë" për të qenë të përshtatshëm për këtë detyrë.

5.4.2 Për sa i takon pretendimit të kërkuesve për nenin 59, Kushtetuta nuk e parashikon pozicionin e zëvendëskryetarit të KLGJ-së, prandaj ajo nuk mund të rregullonte kritere për zgjedhjen e tij.

5.4.3 Lidhur me pretendimin për nenin 62, pikat 8 dhe 13, Kushtetuta nuk shprehet për mënyrën se si vepron KLGJ-ja, për kuorumet përkatëse apo për raportin e anëtarësisë që pretendohet se duhet ruajtur nëpër komisione. Kushtetuta parashikon ekzistencën e këtyre komisioneve, por në asnjë rast nuk përcakton përbërjen apo mënyrën e funksionimit, duke ia deleguar këtë çështje shprehimisht ligjvënësit. Përbërja me shumicë gjyqtarësh është ruajtur pikërisht në ato komisione që kanë të bëjnë me çështje të karrierës së gjyqtarëve, ndërsa planifikimi dhe administrimi i buxhetit kanë natyrë tërësisht të ndryshme nga tri komisionet e tjera.

5.4.4 Nga pikëpamja formale, pretendimet në lidhje me nenin 66, pikat 2 dhe 6, nuk përmenden në objektin e kërkesës. Pika 3 e këtij neni përmendet gabimisht, sepse ajo merret me thirrjen për mbledhje të KLGJ-së. Lidhur me nenin 68, pika 6, që parashikon votën përcaktuese të kryetarit, përmbajtja e tij bazohet në rekomandimin e Komisionit të Venecias. Pretendimi për prirjen më të madhe të gjyqtarëve për të qenë në konflikt interesi është i pabazuar, pasi edhe anëtarët jogjyqtarë mund të kenë shprehur mendimet e tyre për çështje në cilësinë e tyre si avokatë, ekspertë, inspektorë, etj., përderisa janë juristë.

5.4.5 Pretendimi për nenin 76 është krejtësisht hipotetik dhe mbështetet në supozimin e gabuar që anëtarët jogjyqtarë të KLGJ-së janë në konflikt të përhershëm me anëtarët gjyqtarë.

5.5 Për dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 96/2016

5.5.1 Në objektin e kërkesës është kërkuar shfuqizimi i nenit 12, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", por në përmbajtjen e kërkesës nuk është dhënë asnjë argumentim mbi antikushtetutshmërinë e këtyre dispozitave. Për rrjedhojë, pretendimi duhet rrëzuar.

5.5.2 Pretendimet e kërkuesve për shfuqizimin e neneve 42, 43, 47 dhe 53 të ligjit nuk janë ngritur

në nivel kushtetues. Sipas nenit 43, pika 2, shkronja "b", të ligjit transferimi është i hapur edhe për magjistratët e shkallëve më të ulëta, parashikim ky që rrëzon pretendimin e kërkuesve. Vetë procedura e lëvizjes paralele, sipas nenit 43, pika 2, është e hapur si për magjistratët që ushtrojnë funksionin në një gjykatë të të njëjtit nivel me pozicionin e lirë, edhe për magjistratët që ushtrojnë funksionin në një gjykatë të një niveli më të ulët dhe kanë në dy vlerësimet e fundit vlerësimin "shumë mirë". Nenet 42, 43 dhe 47 vendosin procedura e kritere që disiplinojnë karrierën e gjyqtarit, mbështetur në standardet ndërkombëtare, duke përcaktuar kritere meritokratike, bazuar në kualifikimet, aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme. Nëpërmjet këtyre dispozitave ligji ka vendosur kriteret që duhen përmbushur për t'u transferuar, në nivel të njëjtë ose nga një nivel më i ulët, si dhe kriteret minimale për t'u ngritur në detyrë. Për sa i përket nenit 42, pika 8, kërkuesit nuk kanë dhënë asnjë shpjegim se si kjo dispozitë pengon avancimin në karrierë të gjyqtarëve.

5.6 Për dispozitat e kundërshtuara të ligjit nr. 84/2016

5.6.1 Parashikimet e neneve 36, pika 3, dhe 39, pika 1, kanë për qëllim të përcaktojnë se cilat janë kontaktet e papërshtatshme, në mënyrë që të sigurohet që subjekti i rivlerësimit gëzon integritet, si dhe që për publikun të jenë të dukshme pavarësia dhe paanësia e gjyqtarit në ushtrimin e detyrës. Parashikimi i nenit 38, pika 1, në kundërshtim me sa parashtrojnë kërkuesit, nuk mund të kuptohet si bazë ligjore për të kryer përgjime elektronike nga ana e institucioneve të rivlerësimit. Vetëm provat dhe informacionet konfidenciale, si dhe çdo informacion tjetër i marrë në përputhje me ligjin mund të konsiderohen si prova dhe të vlerësohen nga institucionet e rivlerësimit.

5.6.2 Neni 38, pika 4, shkronjat "b" dhe "c", nuk ka për qëllim të zgjerojë rrethin e subjekteve që i nënshtrohen kontrollit të figurës, ndaj pretendimi i kërkuesve është i pabazuar. Koncepti i personit të lidhur krijon premisa për një kontroll të plotë dhe qartësim të objektit të kontrollit. Në analogji me këtë, edhe kontrolli i pasurisë shtrihet te personat e lidhur me subjektin. Bazuar në parashikimin e nenit DH, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës, organet e rivlerësimit mund të përfshijnë në vlerësimin e tyre dhe vendime të gjykatave të shteteve të huaja. Më tej, vetë Kushtetuta, e cila citon "...*dhe provat e tjera, përfshirë*...", nuk kërkon vetëm vendimet e gjykatave si provë. Duke qenë se dispozita kushtetuese nuk është shteruese, ligjvënësi ka detajuar provat që institucionet e rivlerësimit duhet të vlerësojnë për marrjen e vendimit përfundimtar. Neni 38 parashikon standardet e kontrollit të figurës, që nënkupton një vlerësim tërësor të të gjitha fakteve dhe provave, duke marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese të parashikuara. Kjo krijon mundësinë që të bëhet një hetim i plotë dhe i gjithanshëm në lidhje me të dhënat që deklarohen për këtë komponent të procesit.

5.6.3 Neni 37, shkronjat "b" dhe "c", ka të bëjë me detyrat e grupit të punës, me qëllim kryerjen në mënyrë të plotë dhe të saktë të kontrollit të figurës. Ndarja në paragrafë e detyrave të grupit të punës nuk nënkupton plotësimin në mënyrë të veçantë të secilit prej elementeve, por synon unifikimin e standardeve të përgjithshme që aplikohen për këtë kontroll. Grupi i punës në hartimin e raportit duhet të bazohet në rrethana të mirëpërcaktuara, me qëllim që ai të jetë sa më objektiv dhe pa ndikime të karakterit personal, armiqësor ose miqësor, që mund të favorizojnë ose disfavorizojnë subjektin e rivlerësimit.

5.6.4 Pretendimet e kërkuesve në lidhje me nenet 49, pika 2, dhe 54 janë të pabazuara. Kushtetutëbërësi i ka lënë qëllimisht një hapësirë të gjerë vlerësimi ligjvënësit për të përcaktuar se cilat janë provat e tjera dhe në këtë këndvështrim është detyrim i ligjvënësit për të përcaktuar mjetet e duhura të kërkimit të provës, një prej të cilave është bashkëpunëtori i drejtësisë ose prova të tjera gjatë një procesi penal.

5.6.5 Lidhur me pretendimet për përmbajtjen e neneve 4, pika 2, dhe 61, pika 5, shprehja "vlerësim tërësor i procedurave" nuk ka të bëjë aspak me vendosjen e një kriteri të katërt. Bazuar në analizën e rezultateve të hetimit, institucionet e rivlerësimit realizojnë një vlerësim tërësor mbi subjektin e rivlerësimit. Kjo nënkupton se faktet apo gjetjet në kuadër të secilit komponent vlerësimi mund të mos passjellin marrjen e masës disiplinore vetëm për këtë komponent. Por institucioni i

rivlerësimit, bazuar në një vlerësim tërësor të akteve të administruara në kuadër të hetimit për të tre komponentët, krijon bindjen e brendshme se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në sistem cenon "rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi" dhe prandaj ai/ajo nuk mund të qëndrojnë më në sistem. Kjo ka të bëjë me të ashtuquajturën "pavarësi në dukje" të magjistratit.

5.6.6 Për sa i përket nenit 56, pika 1, qëllimi i ligjvënësit është t'i japë mundësi subjektit të rivlerësimit për t'u larguar nga sistemi me dëshirë, pa iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke përfituar edhe një pagesë kalimtare. "Dorëheqja e privilegjuar" nuk duhet ngatërruar me dorëheqjen që çdo subjekt rivlerësimi mund të japë në çdo kohë gjatë procesit të rivlerësimit. Dorëheqja është një e drejtë kushtetuese dhe ligjvënësi nuk ka pasur për synim ta kufizojë atë.

5.6.7 Në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ligji nr. 84/2016 bazohet në parimet e sanksionuara përkatësisht në Kodin e Procedurës Administrative, ligjin "Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe në Kodin e Procedurës Civile. Pretendimet se nenet 54 dhe 37, shkronja "ç", cenojnë të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e krijuar me ligj, janë të pabazuara, pasi organet e rivlerësimit nuk kanë për objekt të veprimtarisë së tyre hetimin mbi një shkelje penale dhe dënimin e personit përtej dyshimit të arsyeshëm. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese, e cila për nga garancitë që ofron si për organin që procedon, ashtu edhe për subjektin e rivlerësimit, bën që të garantohet një proces i rregullt ligjor. Edhe në këtë procedurë çdo provë duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të saj.

5.6.8 Për sa i takon së drejtës për t'u mos u gjykuar mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, opinionet e Komisionit të Venecias kanë sqaruar në mënyrë ezauruese se informacionet konfidenciale mund të përdoren vetëm në favor dhe jo në disfavor të subjektit të rivlerësimit.

5.6.9 Të pabazuara janë edhe pretendimet për nenet 38, pika 1, shkronja "a", 39, pika 2, dhe 49, pika 2. Në vendimin nr. 2, datë 18.1.2017 Gjykata Kushtetuese ka theksuar se dispozitat e ligjit nuk e zhvendosin kontrollin dhe hetimin tek organet ekzistuese, të cilat nuk mund të ushtrojnë kompetencat që i njihen organeve të reja kushtetuese (KPK-së dhe KA-së). Për sa i përket pretendimit se ligji nuk garanton ballafaqimin e subjekteve të rivlerësimit me dëshmitarët në këtë fazë të procesit, sipas ligjit të gjitha provat e grumbulluara nga grupi i punës do t'i nënshtrohen vlerësimit dhe kontrollit përfundimtar nga institucionet e rivlerësimit. Në thelb, në këtë fazë të vlerësimit përpara KPK-së ose KA-së subjekti i rivlerësimit gëzon të drejtën e informimit, të dëgjimit dhe të mbrojtjes, në respektim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.

5.6.10 Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private dhe familjare, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kjo e drejtë nuk është absolute, por mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Interesi publik për kufizimin e saj ka qenë lufta kundër korrupsionit në sistem dhe ky mjet është i nevojshëm për të garantuar qëllimin.

5.6.11 Të pabazuara janë edhe pretendimet për shfuqizimin e nenit 49, pika 1, shkronja "ç". Standardi i vendosur nëpërmjet garancisë që këqyrja dhe kontrolli mund të kryhen vetëm me vendim të gjykatës është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Kjo garanci në fakt mbron subjektet e rivlerësimit nga abuzivizmi apo cenimi i të drejtave të tyre.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

6. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, kërkuesit nuk legjitimohen në paraqitjen e kësaj kërkese për disa arsye. Në aspektin formal, përfaqësuesi që kryetarët e dy shoqatave kanë zgjedhur për t'i përfaqësuar nuk plotëson kushtet që kërkon ligji, pasi sipas shkresës nr. 303, datë 19.6.2017 të

Dhomës Kombëtare të Avokatisë ai nuk rezulton të jetë në listën e avokatëve që kanë të drejtën e përfaqësimit përpara Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë informacion nëse asambletë përkatëse janë mbledhur dhe kanë vendosur të paraqesin këtë kërkesë dhe pa një vendim të tillë kryetarët nuk legjitimohen që t'i drejtohen Gjykatës. Sipas këtij subjekti, kërkuesit nuk legjitimohen as në aspektin substancial, pasi në kërkesën objekt shqyrtimi mungon legjitimiteti për çështje që kapërcejnë "interesin" e gjyqtarit. Sipas statuteve të kërkuesve, anëtarët e tyre janë vetëm gjyqtarë, ndaj ata nuk mund të kundërshtojnë dispozita që kanë të bëjnë me prokurorët apo individë të tjerë. Parashikimet në statut nuk u njohin kërkuesve të drejta themelore, të cilat mund të jepen vetëm nga Kushtetuta. Statuti vetëm i mandaton ata të bëjnë atë që është e nevojshme për të forcuar pavarësinë dhe ndarjen e pushtetit, gjithmonë brenda kuadrit kushtetues e ligjor në fuqi. Në këtë kuptim, kërkuesit nuk kanë legjitimitet lidhur me pretendimet për ligjin nr. 96/2016, me përjashtim të nenit që parashikon kriteret për gjyqtarët që do të zgjidhen në KLGJ dhe jo për ato që lidhen me KLP-në. Po ashtu, nëse interesi i tyre për dispozitat që lidhen me kompetencat e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (ligji nr. 155/2016) do të konsiderohet i mjaftueshëm, çdo shtetas apo nëpunës civil do të legjitimohej të godiste dispozita që rregullojnë pushtetin e institucioneve shtetërore. Ky është një interpretim i gjerë dhe qartësisht nuk është në qëllimet e kushtetutëbërësit, i cili, përkundrazi, e ka kufizuar çështjen e legjitimimit.

7. Gjykata vëren se ndërsa në nenin 131 të Kushtetutës janë parashikuar kompetencat e saj, mes të cilave edhe kontrolli i pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën (pika 1, shkronja "a"), në nenin 134 parashikohen subjektet që mund ta vënë atë në lëvizje për inicimin e këtij kontrolli kushtetues. Gjykata rikonfirmon faktin se me ndryshimet e reja kushtetuese, pjesë e të cilave ka qenë edhe rrethi i subjekteve që mund t'i drejtohen asaj, organizatat janë përfshirë në shkronjën "h" të pikës 1 të nenit 134, por nuk ka ndryshuar kërkesa e pikës 2 të këtij neni, sipas së cilës ky subjekt mund të bëjë kërkesë vetëm nëse provon interesin e tij në lidhje me çështjen. Përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese është zbërthyer në nenin 49 të ligjit nr. 8577/2000, i cili në pikën 4 parashikon se subjektet e kushtëzuara kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre.

8. Në kuptim të këtyre dispozitave Gjykata vlerëson se SHKGJRSH-ja dhe UGJSH-ja legjitimohen *ratione personae*, pasi janë regjistruar si persona juridikë, respektivisht me vendimet nr. 2160, datë 25.1.2008 dhe nr. 2171, datë 4.2.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Siç rezulton nga vendimet për regjistrimin si person juridik, anëtarë të shoqatave kërkuese janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm. Megjithatë, Gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të provohet se këto subjekte përfaqësojnë të gjithë gjyqtarët, pasi në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës një kërkesë e tillë nuk përbën kusht për legjitimimin *(shih vendimet nr. 11, datë 6.4.2010; nr. 11, datë 6.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata vëren, gjithashtu, se këto shoqata, veçmas apo edhe të dyja bashkë, i janë drejtuar disa herë asaj për kontrollin e pajtueshmërisë së normës me Kushtetutën dhe në këtë praktikë nuk është vënë asnjëherë në dyshim legjitimiteti formal dhe procedural i tyre, pavarësisht se cili nga organet drejtuese ka marrë nismën për t'iu drejtuar Gjykatës. Sipas parashikimeve të nenit 13 të statutit të SHKGJRSH-së dhe të nenit 39 të statutit të UGJSH-së, kryetari i shoqatës është organi që përfaqëson këto subjekte në marrëdhënie me të tretët. Megjithatë, në ndryshim nga statuti i UGJSH-së, i cili nuk e përmban një parashikim të tillë specifik, në nenin 11 të statutit të SHKGJRSH-së, i rishikuar dhe ndryshuar me vendimin e datës 3.11.2016 të asamblesë së përgjithshme, parashikohet se këshilli drejtues vendos për goditjen në Gjykatën Kushtetuese të akteve normative që cenojnë statusin e gjyqtarëve. Në kuptim të kësaj dispozite, ky subjekt ka paraqitur vendimin e datës 22.5.2017 të këshillit drejtues të shoqatës, me të cilin është vendosur që t'i drejtohet kësaj Gjykate, sipas objektit të kërkesës në shqyrtim. Gjithashtu, edhe UGJSH-ja, me shkresën e datës 14.7.2017, ka

informuar Gjykatën në lidhje me vendimin e marrë nga bordi drejtues i kësaj shoqate për t'iu drejtuar asaj për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave ligjore të kundërshtuara në kërkesë.

10. Për sa i përket pretendimit tjetër të subjektit të interesuar, në lidhje me përfaqësuesin e kërkuesve, sipas akteve bashkëlidhur kërkesës rezulton se kryetarët e shoqatave kërkuese kanë autorizuar një avokat, anëtar të Dhomës së Avokatisë Tiranë, për të paraqitur kërkesën dhe për t'i përfaqësuar ato para Gjykatës. Sipas nenit 24 të ligjit nr. 8577/2000, të ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Kur çështja kalon për gjykim dhe objekt kërkese është një ligj ose akt normativ, kërkuesi përfaqësohet në gjykim me avokat ose përfaqësues ligjor të specializuar. Në ligjin organik të Gjykatës parashikohet edhe mënyra e paraqitjes së kërkesës, si dhe kriteret për paraqitjen e saj. Sipas nenit 27, pika 1 kërkesa paraqitet nga kërkuesi ose përfaqësuesi i zgjedhur, kurse në rast se kërkuesi ka zgjedhur të përfaqësohet nga një avokat, ai i bashkëngjit kërkesës aktin e përfaqësimit. Sipas pikës 2, shkronja "ë" kërkesa duhet të përmbajë edhe nënshkrimin e kërkuesit ose përfaqësuesit dhe aktin e përfaqësimit. Kërkesa që nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2 konsiderohet e paplotë dhe njoftohet kërkuesi për të bërë plotësimet e nevojshme (pika 5). Sipas nenit 31/a, pika 2 moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur, mes të tjerash, kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet (shkronja "b"), kërkesa është paraqitur nga një person i paautorizuar (shkronja "c") etj. Për rrjedhojë, në kuptim të shqyrtimit paraprak të kërkesës, atë që kryhet në rrugë administrative dhe më pas nga kolegji, kërkesa duhet që të plotësojë kriteret formale, që në rastin konkret janë plotësuar nga kërkuesit në kushtet që i kanë bashkëlidhur kërkesës edhe autorizimin e kryetarëve të shoqatave për caktimin e përfaqësuesit të tyre.

11. Më tej, sipas pikës 3 të nenit 39 të ligjit nr. 8577/2000, i cili përfshihet në kreun VI që parashikon rregullat e funksionimit të Gjykatës dhe shqyrtimit të çështjeve në seancë plenare, përfaqësues të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues mund të jenë avokatët, të cilët pajisen me prokurë ose caktohen si të tillë me deklarim në seancë plenare, kurse sipas pikës 4 të këtij neni është Dhoma Kombëtare e Avokatisë që cakton listën e avokatëve që mund të marrin pjesë në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata vlerëson se ky parashikim ligjor në rastin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare ka për qëllim rritjen e cilësisë së përfaqësimit në gjykimin kushtetues, por nuk mund të konsiderohet si një e metë e tillë që e bën kërkesën të paplotë apo përbën shkak për rrëzimin e saj, për sa kohë që përveçse mund të riparohet nga palët gjatë procesit, ajo nuk parashikohet as si shkak për rrëzimin e kërkesës sipas dispozitave të sipërcituara të ligjit organik.

12. Në lidhje me këtë pretendim, në seancën e datës 28.9.2017 Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga subjekti i interesuar për moslegjitimimin e përfaqësuesit të kërkuesve. Pasi dëgjoi pretendimet e palëve të pranishme, Gjykata, në zbatim të nenit 39, pika 4 të ligjit nr. 8577/2000, si edhe të nenit 19, pika 3, shkronja "c", të ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", vlerësoi se avokati Alban Alimema nuk kishte të drejtën e përfaqësimit të çështjes objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese. Po ashtu, për t'i dhënë mundësi palës kërkuese për caktimin e një përfaqësuesi tjetër, Gjykata vendosi shtyrjen e seancës plenare për në datën 2.10.2017. Në këtë seancë si përfaqësues i SHKGJRSH-së u paraqit kryetari i saj z. Erjon Bani, kurse si përfaqësues i UGJSH-së u paraqit sekretari organizativ i saj, z. Genti Dokollari, sipas autorizimit të lëshuar nga kryetari i bordit drejtues të kësaj shoqate. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se për sa kohë që të metat e përfaqësimit në seancë plenare u korrigjuan nga kërkuesit, pretendimi i subjektit të interesuar në lidhje me legjitimimin formal është i pabazuar.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës subjektet e kushtëzuara, ku përfshihen edhe organizatat, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë.

Organizata që vë në lëvizje gjykimin kushtetues duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi subjektin kërkues nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së tij, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimin nr. 34, datë 10.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata, referuar statutit dhe aktit të themelimit të shoqatave kërkuese, vëren se ato kanë për qëllim mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen dhe forcimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv. Në nenin 1 të statutit të SHKGJRSH-së parashikohet se ajo është një bashkim vullnetar profesional i gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, e krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj. Kurse sipas nenit 3 të statutit qëllimi i veprimtarisë së shoqatës është konsolidimi, forcimi dhe mbrojtja e pavarësisë së gjyqtarëve dhe i sistemit gjyqësor në tërësi; promovimi dhe inspirimi i vlerave të gjyqtarëve në veçanti dhe i sistemit gjyqësor në përgjithësi; zhvillimi i profesionalizmit në gjyqësor; rritja e besueshmërisë së publikut te gjyqësori; zhvillimi dhe implementimi i statusit të gjyqtarëve në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare; rritja e rolit të gjyqtarëve në ushtrimin e funksionit të tyre kushtetues në dhënien e drejtësisë jashtë çdo ndikimi etj. Në nenin 1 të statutit të UGJSH-së parashikohet se ajo është një organizatë jofitimprurëse, vullnetare, e pavarur, profesionale, e cila bashkon gjyqtarë shqiptarë dhe kontribuon në forcimin e një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare. Sipas nenit 8 të statutit qëllimi i veprimtarisë të kësaj shoqate është, ndër të tjera, ndihma në mbrojtjen e interesave profesionalë, intelektualë, etikë, shoqërorë dhe materialë të gjyqtarëve. Duke qenë se qëllimi i kërkuesve është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të gjyqtarëve, është e drejta e tyre që në çdo rast, kur konstatojnë se një normë cenon interesat e tyre, në tërësi ose në veçanti, t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e normës konkrete (*shih vendimin nr. 11, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Sipas nenit 1 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", objekti i tij është përcaktimi i parimeve dhe rregullave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e KLGJ-së, KLP-së, ILD-së, KED-së dhe Shkollës së Magjistraturës. Gjykata vëren se kërkuesit, përveç dispozitave që rregullojnë aspekte të organizimit dhe funksionimit të këshillave gjyqësorë, kanë kundërshtuar edhe dispozita që edhe pse me përmbajtje të njëjtë, janë të zbatueshme për sa u takon prokurorëve dhe këshillave të tyre, konkretisht nenet 157, pika 1, 160, pikat 8 dhe 13, 166, pika 6 dhe 175, pika 2. Duke qenë se në lidhje me këto dispozita kërkuesit nuk provojnë se në çmënyrë ato zbatohen edhe ndaj gjyqtarëve, interesat e të cilëve përfaqësojnë para Gjykatës, ata nuk arrijnë të provojnë interesin për kundërshtimin e tyre. Gjykata konstaton se ajo ka marrë edhe më parë në shqyrtim dhe është shprehur në lidhje me disa dispozita të ligjit nr. 115/2016 që lidhen me organizimin dhe funksionimin e KLP-së. Megjithatë, në atë rast Gjykata është vënë në lëvizje nga një grup deputetësh që përfaqësojnë jo më pak se 1/5-ën e anëtarëve të Kuvendit, të cilët si subjekt i pakushtëzuar nuk nevojitet të justifikojnë interesin e tyre në lidhje me çështjen (*shih vendimin nr. 41, datë 16.5.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione materiae* për kundërshtimin e dispozitave të ligjit nr. 115/2016 që rregullojnë çështje të organizimit dhe funksionimit të KLP-së, konkretisht neni 157, pika 1, shprehja "*zëvendëskryetari*", neni 160, pika 8, shprehja "*2 anëtarë joprokurorë*" dhe pika 13, shprehja "*nga 2 anëtarë joprokurorë dhe 1 anëtar prokuror*", neni 166, pika 6, dhe neni 175, pika 2, pasi nuk arritën të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë mes veprimtarisë që kryejnë dhe përmbajtjes së këtyre dispozitave ligjore të

kundërshtuara.

16. Në lidhje me ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Gjykata vëren se ai ka për objekt përcaktimin e statusit të magjistratëve (neni 1), term që sipas nenit 2/gj të tij i referohet gjyqtarit (me përjashtim të atij të Gjykatës Kushtetuese), prokurorit dhe kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, përshirë kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme. Gjykata vëren se dispozitat e kundërshtuara i referohen magjistratit pa bërë asnjë dallim midis gjyqtarit dhe prokurorit, për rrjedhojë në lidhje me këto dispozita kërkuesit legjitimohen, pasi ato zbatohen drejtpërdrejt ndaj anëtarëve të tyre.

17. Për sa i takon ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në nenin 1 të tij parashikohet se ai ka për qëllim përcaktimin e rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit, që sipas nenit 3, pika 16, të këtij ligji, i cili referon te neni 179/b i Kushtetutës, janë gjyqtarët dhe prokurorët, përshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë KLD-së. Në kushtet kur dispozitat e këtij ligji zbatohen në mënyrë të njëjtë ndaj çdo subjekti të rivlerësimit, pra edhe ndaj anëtarëve të shoqatave kërkuese, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen për kundërshtimin e tyre.

18. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të përcaktuar në nenin 50, pika 1 të ligjit nr. 8577/2000.

B. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese [1]

19. Gjykata vëren se të tria ligjet e kundërshtuara nga kërkuesit janë marrë edhe më parë në shqyrtim prej saj. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse në rastin konkret ndodhemi përpara gjësë së gjykuar dhe nëse ajo mund të shprehet sërish për përmbajtjen e këtyre akteve të kundërshtuara.

20. Sipas kërkuesve në rastin konkret nuk jemi përpara gjësë së gjykuar dhe Gjykata nuk ka asnjë pengesë për t'i marrë sërish në shqyrtim dispozitat e kundërshtuara, për arsye se disa prej tyre nuk kanë qenë pjesë e objektit të kërkesave të sipërcituara, kurse disa të tjerave nuk u është dhënë përgjigje në themel, pasi është vlerësuar se nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Në këtë mënyrë, sipas tyre, Gjykata e ka lënë të hapur mundësinë që nëse ngrihen argumente kushtetuese, ato mund t'i nënshtrohen përsëri gjykimit kushtetues.

21. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale *(shih vendimin nr. 18, datë 14.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Efekti detyrues i këtyre vendimeve ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Ky efekt që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbën edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Në këtë pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë ajo (*shih vendimin nr. 44, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me parimin *res judicata* Gjykata ka theksuar se në të drejtën kushtetuese ajo njihet si

[1] Gjyqtarja Vitore Tusha votoi për mungesën e juridiksionit të Gjykatës për shqyrtimin e tre ligjeve objekt i kërkesës, për arsye se ndodhemi para gjësë së gjykuar.

një nga tri format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal e procedural gjë e gjykuar nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit. Ky parim është i zbatueshëm jo vetëm ndaj palëve në gjykim, por edhe ndaj të gjitha autoriteteve publike brenda juridiksionit, që janë të interesuara ose të përfshira në përmbajtjen e vendimit të gjykatës. Tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur nuk është shprehur papajtueshmëria kushtetuese e normës juridike, kërkuesi nuk ndalohet të bëjë përsëri të njëjtën kërkesë për kontrollin e pajtueshmërisë së normës me Kushtetutën. Kjo gjë varet nga pjesa arsyetuese e vendimit, sepse rrëzimi i kërkesës mund të jetë vendosur për shkaqe të tjera (*shih vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 33, datë 10.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar edhe rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit subjekt, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkese tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji i saj organik, janë ngritur shkaqe të reja për antikushtetutshmërinë e aktit të kundërshtuar (*shih vendimet nr. 29, datë 21.12.2006; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për të arritur në rastin konkret në përfundimin nëse ndodhemi para gjësë së gjykuar, në vijim Gjykata, për secilin nga ligjet objekt i kësaj kërkese, do të analizojë si objektin dhe përmbajtjen e kërkesave të mëparshme që i janë paraqitur asaj në lidhje me këto tri ligje, ashtu edhe përmbajtjen e kërkesës në shqyrtim, si dhe qëndrimin e mbajtur prej saj në vendimet që janë shprehur në lidhje me këto kërkesa.

B.1. Për ligjin nr. 84/2016

25. Në lidhje me ligjin nr. 84/2016, Gjykata vëren se në kërkesën e parë të datës 5.10.2016, të shqyrtuar prej saj me vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, u kundërshtua në tërësinë e tij ky akt normativ, duke u evidentuar përmbajtja e dispozitave konkrete të ligjit që rregullonin çështje të caktuara, me pretendimin se bie ndesh me disa parime kushtetuese, si edhe cenon të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit. Në atë gjykim kërkimet dhe pretendimet e ngritura nga kërkuesi, një grup deputetësh të Kuvendit, u mbështetën edhe nga kërkuesja UGJSH-ja, e cila mori pjesë në të në cilësinë e subjektit të interesuar.

26. Gjykata vëren se në kërkesën në shqyrtim janë kundërshtuar disa nga dispozitat që rregullojnë standardet dhe procedurën e kontrollit të figurës, konkretisht nenet 36, pika 3; 37, shkronjat "b", "c" dhe "ç"; 38, pikat 1 dhe 4, shkronjat "b", "c" dhe "d"; 39, pika 1. Po ashtu, janë kundërshtuar nenet 4, pika 2, dhe 61, pika 5 në pjesën që e lidhin shkarkimin me vlerësimin tërësor të procedurave apo cenimin e besimit të publikut; neni 49, pika 1, shkronja "ç", që u referohet mjeteve për kërkimin e provës; neni 54, që i referohet bashkëpunëtorit të drejtësisë; neni 56, që rregullon institutin e dorëheqjes, të cilat janë kundërshtuar edhe në kërkesën e parë të shqyrtuar prej saj. Për rrjedhojë, në rastin konkret duhet vlerësuar nëse shkaqet e ngritura në këtë kërkesë janë të njëjta me ato të parashtruara në kërkesën e parë të marrë në shqyrtim nga Gjykata.

27. Duke krahasuar përmbajtjen e të dyja kërkesave rezulton se në kërkesën e parë u pretendua se përmbajtja e neneve 4, pika 2, 59, pika 2 dhe 61, pika 5 ka zgjeruar rastin e shkarkimit nga detyra me nocione të reja, siç janë vlerësimi tërësor i procedurave dhe cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, të cilat janë nocione të papërkufizuara dhe subjektive dhe përbëjnë tejkalim të kritereve që ka parashikuar Kushtetuta.

28. Në kërkesën në shqyrtim kërkuesit pretendojnë se nenet 4, pika 2 dhe 61, pika 5 bien në kundërshtim me nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës. Sipas tyre, dispozita kushtetuese ka parashikuar se rivlerësimi bazohet vetëm në tre komponentë, kurse dispozitat ligjore, në kundërshtim me parimin e hierarkisë së akteve ligjore, shtojnë edhe një kriter të katërt që i referohet vlerësimit tërësor të procedurave.

29. Në lidhje me përmbajtjen e neneve 37, 38 dhe 39 të ligjit, në kërkesën e parë u pretendua se ato cenojnë parimin e shtetit të së drejtës, si dhe të drejtën për një proces të rregullt, pasi nuk respektojnë parimet kushtetuese për marrjen, administrimin dhe çmuarjen e provave. Neni 37 përbën tejkalim të konceptit kushtetues të kontrollit të figurës sipas nenit DH të Aneksit, pasi e ka zgjeruar objektin e kontrollit të figurës jo vetëm te kontakti i papërshtatshëm me personat e lidhur me krimin e organizuar, por edhe te hipoteza të tjera. Vlerësimi që bën grupi i punës sipas kësaj dispozite, përfshin vlerësimin psikologjik të subjektit, i cili del jashtë natyrës së kontrollit të figurës, kurse verifikimi i përfshirjes në krimin e organizuar është kompetencë e organit të prokurorisë. Neni 38 ka deformuar qëllimin e kontrollit, pasi ka përcaktuar standarde që konsiderojnë kontakt të papërshtatshëm edhe ato që nuk kanë asnjë ndikim tek ushtrimi i rregullt i detyrës. Ai përmban koncepte që janë shmangie nga koncepti i provave që përmend neni DH, pika 1, i Aneksit të Kushtetutës.

30. Në kërkesën në shqyrtim pretendohet se këto dispozita cenojnë parimin e hierarkisë së akteve ligjore dhe atë të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Në tejkalim të përmbajtjes së nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, nenet 36 dhe 39 të ligjit e shtrijnë hetimin edhe te personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe verifikimin e kontakteve me këta persona. Më tej, parashikimi i nenit 37 për vlerësimin e tendencave kriminale, nuk është objekt i vlerësimit të figurës sipas normës kushtetuese. Kontrolli që ushtron grupi i punës sipas nenit 37, shkronja "ç", është kompetencë kushtetuese e organit të prokurorisë, ndërsa gjykimi i Gjykatës për Krimet e Rënda. Në këtë mënyrë kjo dispozitë cenon edhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Po ashtu, neni 38 shtrihet edhe te personat e lidhur, ndërkohë që sipas Kushtetutës qëllimi i procesit të rivlerësimit është identifikimi i kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit. Sipas nenit DH të Aneksit të Kushtetutës kontrolli bazohet në prova që kanë fuqi të plotë provuese dhe që janë publike, ndërsa neni 38, pika 3 parashikon se kontrolli përfshin edhe vlerësimin e informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatim. Kërkuesit pretendojnë, gjithashtu, se nenet 38 dhe 39 të ligjit cenojnë të drejtën e mbrojtjes efektive dhe barazisë së armëve.

31. Në lidhje me nenin 49, pika 1, shkronja "ç", të ligjit, në kërkesën e mëparshme u pretendua se ai nuk parashikon asnjë rregull se si realizohet këqyrja dhe kontrolli i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, rastet kur kjo është e lejueshme apo e nevojshme, si dhe cila është gjykata kompetente në kuptim të kësaj dispozite.

32. Në kërkesën në shqyrtim pretendohet se nenit 49, pika 1, shkronja "ç", i mungon qartësia dhe kriteret se kur vendoset kontrolli i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme. Në mungesë të kritereve të qarta e të përcaktuara, ekziston mundësia e abuzimit nga organet e rivlerësimit, duke u cenuar parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e respektimit të jetës private.

33. Për sa i përket nenit 54 të ligjit, në kërkesën e mëparshme u pretendua se ky nen së bashku me nenin 53 lejojnë marrjen e informacioneve nga publiku pa përmbushur standardin e parashikuar në nenin Ç, pika 2, të Aneksit të Kushtetutës. Ligji parashikon se një dëshmi e dhënë përpara prokurorit në kuadër të një marrëveshjeje bashkëpunimi përbën një provë thelbësore, çka del jashtë objektit të rivlerësimit, pasi veprimi korruptiv në këtë rast duhet të ndiqet nga organi i prokurorisë dhe dënimi i subjektit duhet të sjellë shkarkimin e tij. Këto parashikime, në kundërshtim me nenet 42 dhe 32, pika 2, të Kushtetutës, cenojnë rregullat për administrimin, mbledhjen apo vlerësimin e provave dhe e shndërrojnë procesin nga objektiv në subjektiv, që bazohet në të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme dhe pa asnjë kriter ligjor.

34. Në kërkesën në shqyrtim pretendohet se përmbajtja e neneve 54 dhe 49, pika 2, del tej objektit të procesit të rivlerësimit. Sipas kërkuesve, marrja dhe administrimi si provë i deklaratës së dhënë para prokurorit nuk ka asnjë vlerë në procesin e rivlerësimit, pasi nuk mund të provojë asnjë nga komponentët e tij. Për rrjedhojë, cenohet edhe parimi i prezumimit të pafajësisë, pasi për sa kohë që nga prokuroria fillon një hetim penal, subjekti i rivlerësimit prezumohet i pafajshëm derisa të provohet fajësia me vendim të formës së prerë, si edhe e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi në proces asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, por ajo i nënshtrohet debatit dhe vlerësohet në unitet me provat e tjera. Parashikimi i nenit 54 cenon edhe parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, pasi gjykimi i çështjeve penale është në kompetencë të Gjykatës për Krimet e Rënda si gjykatë e caktuar me ligj.

35. Kurse për sa i takon nenit 56 të ligjit, në kërkesën e parë u pretendua se ai bie ndesh me nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 49 të Kushtetutës, pasi cenon të drejtën e subjektit të rivlerësimit për të zgjedhur punën e tij. Kjo sepse akti i dorëheqjes është një akt vullnetar dhe nuk mund të jetë i kufizuar në kohë.

36. Në kërkesën në shqyrtim pretendohet se kjo dispozitë bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës dhe të hierarkisë së akteve ligjore, për arsye se tejkalon parashikimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Dispozita kushtetuese nuk ka natyrën e një dispozite deleguese, pasi ajo nuk ka parashikuar ndonjë rezervë ligjore për ligjvënësin. Nëse subjekti jep dorëheqjen, atëherë procesi i rivlerësimit mbetet pa objekt, ndaj ai duhet të pushohet sipas parashikimit kushtetues.

37. Pasi më sipër janë evidentuar pretendimet e ngritura nga kërkuesit në të dyja kërkesat e paraqitura para Gjykatës, ajo vlerëson të ndalet në vijim në qëndrimin e mbajtur prej saj në vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, me të cilin është shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me Kushtetutën të përmbajtjes së ligjit nr. 84/2016. Gjykata vëren se në këtë vendim vlerësimi i saj është ndalur në kuptim të standardeve dhe frymës së përgjithshme që përshkon ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", duke pasur parasysh edhe qëndrimet e mbajtura nga Komisioni i Venecias në opinionin e përgatitur me kërkesë të Gjykatës për këtë qëllim. Gjykata i analizoi dispozitat e këtij ligji në frymën e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, duke zbatuar standardin e interpretimit pajtues me Kushtetutën, në mënyrë të veçantë me nenin 179/b dhe Aneksin e saj (*shih paragrafin 25 të vendimit*). Në përputhje me këtë standard, për sa i takon procesit të kontrollit të figurës, bazuar në përmbajtjen e neneve 35-39 të ligjit që përcaktojnë thelbin e kompetencave që ligji u ka njohur organeve të tjera të përfshira në proces, pra ato që lidhen me realizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave dhe të vlerësimit të figurës së subjektit të rivlerësimit, Gjykata theksoi se institucionet kushtetuese të rivlerësimit kanë autoritetin për të pasur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe akses te të gjitha materialet përkatëse. Përdorimi i kontrolleve për qëllime të procesit të rivlerësimit, sipas dispozitave të kreut V të ligjit, duhet të jetë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e KPK-së dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollit të KA-së (*shih paragrafin 39 të vendimit*).

38. Sipas Gjykatës, dispozitat e ligjit garantojnë aksesin në të gjithë informacionin dhe dokumentet e disponuara nga grupi i punës, si dhe kontrollin efektiv mbi veprimtarinë e grupeve të punës nga KPK-ja. Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale, që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KA-ja), të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme (*shih paragrafin 40 të vendimit*). Në kuadër të procesit të rivlerësimit shkarkimi i gjyqtarit, ashtu si në rastet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, kryhet pas një procesi të vlerësimit të shkaqeve dhe provave të administruara nga organet disiplinore apo ato të rivlerësimit, sipas rastit, dhe pas një procesi të bazuar në prova, si dhe

duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Në përfundim të këtij lloj gjykimi organi përkatës që vendos shkarkimin jep një vendim të arsyetuar për shkaqet që kanë çuar në këtë vendimmarrje (*shih paragrafin 47 të vendimit*).

39. Gjykata, duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit të kundërshtuar, nga konteksti i tyre, si dhe nisur nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, vlerësoi se qëllimi i tyre është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen gjatë procesit të rivlerësimit nga organet kushtetuese të pavarura, të cilat janë të vetmet organe që kanë kompetencën për të realizuar kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe i kritereve dhe mënyrës së realizimit të këtij procesi. Sipas saj, "*e gjithë fryma që përshkon dispozitat kushtetuese dhe që reflektohet edhe në dispozitat konkrete të ligjit të kundërshtuar është se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit me ndihmën e organeve të tjera shtetërore ekzistuese, të cilat për shkak të qëllimit për të cilin janë krijuar, mënyrës së organizimit dhe funksionimit, si dhe kompetencave që ushtrojnë do të ndihmojnë organet e rivlerësimit në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe përmbushjen e misionit të tyre. Kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të. Vetëm duke garantuar se organet e rivlerësimit do të kenë kontrollin e plotë të këtij procesi dhe, nëse është e nevojshme, mundësinë të përcaktojnë edhe modalitete të tjera të bashkëpunimit me organet ekzistuese, rast pas rasti, Gjykata vlerëson se do të garantohet respektimi i parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe do të parandalohet ushtrimi i kompetencave ligjore në mënyrë të pakontrolluar nga ana e organeve ekzistuese*" (*shih paragrafin 44 të vendimit*).

40. Në këtë vendim u vlerësua përmbajtja e ligjit nr. 84/2016 edhe në drejtim të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Sipas saj, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, KPK-ja dhe KA-ja ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme mbi bazën e parimit të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor dhe, kur është rasti, mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Sipas nenit 47 të ligjit, të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35 - 40 dhe neneve 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Po ashtu, ligji ka parashikuar detyrimin për njoftimin e subjektit të rivlerësimit (neni 46), të drejtën e subjektit për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore (neni 55), detyrimin e institucionit të rivlerësimit për të arsyetuar vendimin (neni 57), të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u ankuar ndaj vendimit të KPK-së (neni 63), si edhe ka përcaktuar rregullat e gjykimit në KA në përputhje me rregullat e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative (neni 65) etj. Edhe pse ligji nuk ka parashikuar afate specifike për shqyrtimin e çështjeve apo vendimmarrjen e organeve të rivlerësimit, kjo nuk nënkupton *a priori* se procesi do të shkaktojë vonesa të paarsyeshme. Për shkak të natyrës specifike të këtij procesi, kushtetutëbërësi ka vlerësuar të mjaftueshme të parashikojë se në ushtrimin e kompetencave të tyre organet e rivlerësimit u nënshtrohen jo vetëm rregullave të procesit të rregullt, një element i së cilit është edhe shqyrtimi i çështjeve brenda afateve të arsyeshme, por bazohen edhe në dispozita të tjera procedurale, për aq sa janë të zbatueshme (*shih paragrafët 74 dhe 75 të vendimit*).

41. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se ofrohen të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (*shih paragrafët 66 dhe 67 të vendimit*). Për më tepër, Gjykata

theksoi se në përfundim të procesit të rivlerësimit KPK-ja jep një vendim të arsyetuar në lidhje me provat dhe arsyet ku është mbështetur, si dhe për përfundimet e nxjerra prej tij (*shih paragrafin 55 të vendimit*).

42. Edhe në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për jetë private dhe familjare, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë (*shih paragrafin 64 të vendimit*).

43. Në lidhje me nenin 54 të ligjit, Gjykata vlerësoi se në çdo rast subjektit të rivlerësimit i garantohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, edhe pse nga kërkuesi nuk ishte dhënë asnjë argument për antikushtetushmërinë e kësaj dispozite. Në vlerësimin e Gjykatës dëshmia e dhënë nga bashkëpunëtori i drejtësisë, sipas nenit 54 të ligjit, do të konsiderohet provë vetëm nëse do të merret nga organet kushtetuese të ngarkuara për këtë qëllim. Edhe për sa i takon nenit 56, pika 1, të këtij ligji, kjo dispozitë është vlerësuar si kushtetuese për sa kohë që nuk i mohon subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u dorëhequr, e drejtë që i garantohet atij nga neni G i Aneksit të Kushtetutës. Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

44. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se ajo ka marrë në shqyrtim në vendimin e saj jo vetëm frymën që përshkon ligjin nr. 84/2016, por edhe kompetencat që ushtrojnë organet e rivlerësimit në kuptim të përmbajtjes së tyre dhe hapësirës ku ato shtrihen. Në këtë kuptim, Gjykata i ka analizuar ato jo vetëm në drejtim të respektimit të standardeve kushtetuese, por edhe të të drejtave të njeriut, veçanërisht të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në disa nga elementet e saj, dhe asaj për respektimin e jetës private dhe familjare.

45. Duke vënë edhe një herë theksin në fuqinë detyruese të vendimeve të saj, nga e cila nuk bën përjashtim as kjo Gjykatë, ajo rithekson se jurisprudenca kushtetuese nuk mund të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që mohon pajtueshmërinë e vlerave me njëra-tjetrën, që redukton garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që mohon konceptimin e Kushtetutës si një akt i vetëm dhe sistem harmonik, që redukton garancitë e të drejtave dhe lirive të sanksionuara dhe që ndryshon modelin e ndarjes së pushteteve të rregulluara në Kushtetutë. Pavarësisht argumenteve të paraqitura nga kërkuesit, Gjykata vlerëson se ato nuk janë të tilla që të vënë në diskutim vendimmarrjen e mëparshme të saj. Gjykata rithekson se organet e reja kushtetuese gjatë realizimit të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë detyrimin që të respektojnë standardet kushtetuese dhe të drejtat e subjekteve të rivlerësimit, si edhe jurisprudencën e kësaj Gjykate.

46. Për sa më sipër, duke vlerësuar përmbajtjen e të dyja kërkesave të paraqitura para saj, si edhe përmbajtjen e vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, Gjykata vlerëson se në rastin konkret ndodhemi para gjësë së gjykuar, për rrjedhojë pretendimet në lidhje me dispozitat e ligjit nr. 84/2016 nuk mund të merren në shqyrtim prej saj.

B.2. Për ligjin nr. 96/2016

B.2.1. Për juridiksionin e Gjykatës

47. Për sa u takon dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 96/2016, Gjykata vëren se disa prej tyre kanë qenë objekt edhe i kërkesës së datës 2.12.2016, shtesës së saj të datës 7.12.2016, dhe më tej të parashtrimeve të datës 8.3.2017, konkretisht neni 12, pika 2, shkronja "b", pjesa e fundit e fjalisë;

neni 42, pikat 3, 8 dhe 9; neni 43; neni 47, pikat 2, 4 dhe 5 të tij. Në lidhje me përmbajtjen e nenit 12, pika 1, shkronja "b", kërkuesit pretenduan se binte ndesh me nenin 18 të Kushtetutës, që sanksionon parimin e barazisë para ligjit, dhe nenin 17 të saj, pasi kufizon jo për interes publik dhe në mënyrë joproporcionale pagën e magjistratëve që ushtrojnë funksionin në gjykatën e posaçme shkalla e parë, e cila kualifikohet në grupin G2, kundrejt pagës së magjistratëve që ushtrojnë funksionin e prokurorit pranë së njëjtës gjykatë, të përfshirë në Prokurorinë e Posaçme, e cila kualifikohet në grupin G3. Pasi ka marrë në shqyrtim përmbajtjen e këtyre dispozitave, me vendimin e saj nr. 34, datë 10.4.2017 Gjykata nuk ka konstatuar cenimin e standardeve dhe normave kushtetuese të pretenduara.

48. Në lidhje me nenin 42, pikat 3, 8 dhe 9, që përcaktojnë parimet e transferimit, nenin 43, që parashikon procedurën e lëvizjes paralele dhe nenin 47, pikat 2, 4 dhe 5 të tij, që përcaktojnë kriteret e ngritjes në detyrë, në kërkesën e parë të marrë në shqyrtim kërkuesit pretenduan se ato binin ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e karrierës. Sipas tyre, nenet 42 dhe 43 parashikojnë një institut të ri, me anë të të cilit nuk synohet gjë tjetër veçse të pengohet që gjyqtarët e shkallës së parë që plotësojnë kërkesat ligjore sipas nenit 47 të ligjit të paraqesin kërkesë për t'u emëruar si gjyqtarë apeli. Duke parashikuar se vendet e lira që krijohen në çdo gjykatë mund të plotësohen vetëm me anë të lëvizjes paralele, ligji ka sjellë një kufizim që është në kundërshtim edhe me nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës. Po ashtu, dispozitat e nenit 47 që përcaktojnë kriteret e ngritjes në detyrë, parashikojnë ndalime disproporcionale, siç është eksperienca në një seksion të posaçëm apo në fushën e së drejtës të përshtatshme me pozicionin e lirë, duke cenuar të drejtën e karrierës si një nga elementet e statusit të gjyqtarit, e parashikuar nga neni 138 i Kushtetutës. Edhe në lidhje me përmbajtjen e këtyre dispozitave Gjykata nuk ka konstatuar cenimin e standardeve kushtetuese të përmendura më sipër.

49. Duke iu referuar pretendimeve të paraqitura në kërkesën në shqyrtim, rezulton se në lidhje me përmbajtjen e nenit 12, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", kërkuesit pretendojnë se ato bien ndesh me nenet 49 dhe 18 të Kushtetutës, pasi nuk u garantojnë gjyqtarëve një trajtim sipas vendit të punës, njëlloj me prokurorinë e së njëjtës shkallë dhe të të njëjtit funksion. Sipas tyre, këto dispozita, në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të Kushtetutës, kufizojnë jo për interes publik dhe në mënyrë joproporcionale pagën e magjistratëve që ushtrojnë detyrën në gjykatën e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar krahasuar me magjistratët e Prokurorisë së Posaçme, pasi këto dy kategori, edhe pse ndodhen në të njëjtën shkallë të sistemit të drejtësisë, paguhen me paga të ndryshme.

50. Gjykata vëren se në objektin e kërkesës në shqyrtim është kundërshtuar edhe shkronja "c" e pikës 2 të nenit 12, por në përmbajtjen e kërkesës janë ngritur pretendime vetëm për fjalinë e fundit të shkronjës "b" të këtij neni, i cili kategorizon pagën e magjistratëve të gjykatave të posaçme sipas grupit G2. Kurse në lidhje me përmbajtjen e disa dispozitave të neneve 42, 43 dhe 47 të ligjit, ato janë kundërshtuar në kërkesën në shqyrtim duke pretenduar se bien ndesh me parimin e shtetit të së drejtës, të drejtën e karrierës së gjyqtarëve, të drejtën për të zgjedhur vendin e punës, si dhe me parimin e sigurisë juridike. Me të njëjtat argumente si në kërkesën e mëparshme, kërkuesit pretendojnë se nenet 42 dhe 43, duke parashikuar se vendet e lira që krijohen në çdo gjykatë apeli mund të plotësohen vetëm me anë të lëvizjes paralele nga gjyqtarët e tjerë të gjykatave të apelit dhe jo edhe nga gjyqtarët e shkallës së parë, synojnë që të mos lejojnë këta të fundit të paraqesin kërkesë për t'u promovuar ose ngritur në detyrë në gjykatat e apelit. Këto dispozita pengojnë gjyqtarët e shkallës së parë që pasi të kenë plotësuar kriteret ligjore të kenë mundësi të paraqesin kërkesë për të kandiduar si gjyqtarë apeli, çka do të përbënte karrierën normale dhe të zakonshme të çdo gjyqtari. Për të njëjtat argumente janë kundërshtuar nga kërkuesit edhe disa nga dispozitat e nenit 47 të ligjit nr. 96/2016.

51. Në përfundim, duke krahasuar të dyja kërkesat e paraqitura nga kërkuesit, Gjykata vëren se në lidhje me nenin 12, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", nenin 42, pika 3, shkronja "a", "b", "c" dhe "ç"

dhe pikat 8 e 9 të tij, nenin 43 dhe nenin 47, pika 2, shkronja "a", shprehja "*...nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale...*", shkronja "b", shprehja "*...nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale...*", pika 4, shprehja "*...nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë...*" dhe pika 5, shprehja "*nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë*", pretendimet e ngritura në këtë kërkesë janë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën e marrë më parë në shqyrtim prej saj me vendimin nr. 34, datë 10.4.2017. Në kushtet kur në të dyja kërkesat në thelb janë paraqitur të njëjtat argumente, ato nuk mund të merren në shqyrtim në këtë gjykim, pasi përbëjnë gjë të gjykuar.

52. Për sa i takon pjesës tjetër të objektit të kërkesës në shqyrtim, konkretisht nenit 53, pikat 11 dhe 12, të ligjit nr. 96/2016, Gjykata vëren se këto dispozita nuk janë kundërshtuar më parë para saj, për rrjedhojë ato do t'i nënshtrohen kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën.

B.2.2. Për pretendimin e cenimit të parimit të shtetit të së drejtës dhe karrierës së gjyqtarëve

53. Sipas kërkuesve, pikat 11 dhe 12 të nenit 53 të ligjit krijojnë dyshime për devijim nga rregullat kushtetuese të procedimit disiplinor të magjistratëve në disa aspekte. Sipas nenit 147/a të Kushtetutës përgjegjëse për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve është vetëm KLGJ-ja, kurse sipas nenit 147/d ILD-ja është përgjegjëse për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratëve, ndërkohë që ligji bën zhvendosjen e kompetencave ekskluzive të organeve kushtetuese në organe të tjera. Ai bën përgjegjës herë nëpunësit civilë dhe herë drejtuesin e institucionit të komanduar, kancelarin apo organe të paidentifikuara. Ligji, në ndryshim nga Kushtetuta, parashikon se për të gjitha masat disiplinore procedimi disiplinor ushtrohet nga institucioni ku magjistrati është komanduar. Për sa i takon masës së shkarkimit është në vullnetin e subjektit të proceduar për të zgjedhur institucionin që do ta gjykojë. Në paragrafin e parë të tij neni 53 e kushtëzon komandimin e magjistratit, me kushtin që pozicioni i komanduar të jetë i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të magjistratit. Ndërkohë që në pikën 11 po kjo dispozitë parashikon se magjistratit mund t'i rregullohet përgjegjësia disiplinore edhe me ligje të thjeshta, me akte nënligjore dhe akte të brendshme siç janë rregulloret. Akoma më tej, pika 12 e këtij neni e quan të pajtueshëm me statusin dhe pavarësinë e magjistratit edhe faktin se ai ndiqet disiplinarisht nga organe të pushtetit ekzekutiv, legjislativ apo gjyqësor.

54. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, në lidhje me pikën 11 të nenit 53 kërkuesit nuk kanë sjellë asnjë argument për të legjitimuar kërkesën e tyre. Po ashtu, vërehet se kjo dispozitë nuk ka asnjë referencë në procedurën disiplinore të pretenduar, ndaj pretendimi është i pabazuar. Komandimi është përfshirë në ligjin nr. 96/2016 si një institut i ri, me rregulla të reja të përcaktuara, duke mbajtur në konsideratë standardet ndërkombëtare në respektimin e të drejtave të magjistratëve, si dhe parashikimet kushtetuese. Duke pasur parasysh specifikat e komandimit, ligji ka parashikuar rregulla të posaçme për trajtimin e magjistratëve në pozicionin e jomagjistratit. Gjatë periudhës së komandimit magjistrati ushtron veprimtarinë në një institucion tjetër, vepron nën autoritetin e titullarit të një institucioni, veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të posaçëm, si dhe vepron në të në pozicion jomagjistrati. Për këtë arsye është e natyrshme që në këtë periudhë ai t'u nënshtrohet rregullave të veprimtarisë së punës specifike të atij institucioni. Është në detyrimin e ligjvënësit që për situata të veçanta, si ajo e angazhimit në një pozicion jomagjistrati, të parashikojë rregullat e nevojshme të angazhimit, të drejtat, por edhe detyrimet e subjektit kundrejt institucionit ku është angazhuar, ku përfshihet edhe procesi disiplinor dhe masat disiplinore eventuale në ngarkim të tij.

55. Gjykata vëren se edhe pse kërkuesit kanë kundërshtuar në objekt të kërkesës si pikën 11, ashtu edhe pikën 12 të nenit 53 të ligjit nr. 96/2016, argumentet e tyre i referohen vetëm përmbajtjes së pikës 12 të këtij neni, e cila rregullon përgjegjësinë disiplinore të magjistratit gjatë komandimit. Për sa i takon pikës 11, e cila i referohet vlerësimit etik dhe profesional të magjistratit nga institucioni në të cilin është komanduar, kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tyre për

jokushtetutshmërinë e kësaj dispozite.

56. Neni 138 i Kushtetutës përcakton elementet përbërëse të statusit të gjyqtarit, pa të cilat nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tij. Sipas tij, paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve të parashikuara nga po kjo dispozitë. Gjykata rithekson se karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre dhe mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse, me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë. Statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që priten në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Sipas jurisprudencës kushtetuese, ligjvënësi duhet të kujdeset edhe për funksionimin sa më mirë të pushtetit gjyqësor, me qëllim realizimin e misionit që gjyqtarët kanë, pra atë të dhënies së drejtësisë. Drejtësia mund të jetë e besueshme dhe me integritet kur jepet nga gjyqtarë që nuk ngjallin dyshime për sa i takon figurës së tyre (*shih vendimin nr. 34, datë 10.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

57. Parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta e karrierës, si pjesë përbërëse e statusit të gjyqtarit dhe një nga përfitimet e tjera që gjyqtarët gëzojnë për shkak të funksionit. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave te shteti e ligji dhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë (*shih vendimin nr. 11, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Kushtetutëbërësi në nenet 147, 147/a, 147/b, 147/c dhe 147/ç ka përcaktuar kompetencat, rastet e përgjegjësisë disiplinore, ato të mbarimit të mandatit të anëtarit të KLGJ-së, si dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit. Sipas shkronjës "a" të paragrafit 1 të nenit 147/a, Këshilli emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve, kurse sipas shkronjës "b" ai vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve. Gjykata vëren se sipas pikës 12 të nenit 53 të ligjit të kundërshtuar: "*Magjistrati, gjatë komandimit, ka përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve që zbatohen për anëtarët e institucionit në të cilin magjistrati është komanduar. Në rastet kur institucioni në të cilin magjistrati është komanduar propozon shkarkimin e magjistratit si masë disiplinore, magjistrati i komanduar mund të kërkojë referimin e çështjes te Këshilli. Në këtë rast Këshilli shqyrton çështjen dhe zbaton procedurën disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji. Institucioni në të cilin është komanduar magjistrati merr pjesë në procedurën disiplinore me të drejtat dhe detyrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*" Bazuar në këtë dispozitë, por edhe në përmbajtjen e pikës 13 të këtij neni, rezulton se në rastet e përgjegjësisë disiplinore me pasojë shkarkimin e magjistratit të komanduar, ligji ka parashikuar edhe kompetencën e institucionit në të cilin ai është komanduar për të vendosur në lidhje me masën e shkarkimit, në situatën kur çështja nuk është referuar në Këshill nga vetë magjistrati i proceduar.

59. Gjykata vëren se komandimi, sipas pikës 1 të nenit 53, është lëvizja e magjistratit në një pozicion jomagjistrati në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, pozicion që është i pajtueshëm me pavarësinë dhe mbajtjen e statusit të tij. Pika 2 e këtij neni ka përcaktuar institucionet në të cilat magjistrati komandohet, kurse sipas pikës 3, me përjashtim të rasteve të caktimit në pozicion të sapoemëruarve, magjistratët mund të komandohen vetëm me pëlqimin e tyre. Sipas pikës 6 periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj dhe kjo periudhë llogaritet si përvojë në profesion (pika 9).

60. Sipas shkronjës "gj" të nenit 2 të ligjit nr. 96/2016, "magjistrat" është gjyqtari, me përjashtim të atij të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetarët në kuptim të shkronjës "g" të këtij neni.

Kurse sipas shkronjës "h" të këtij neni, "ndihmësmagjistrat" është gjyqtari i komanduar për të ndihmuar gjyqtarët në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese, si dhe prokurori i komanduar për të ndihmuar Prokurorin e Përgjithshëm në trajtimin e çështjeve. Për këtë qëllim, veprimtaria e tyre përfshin, në veçanti, kryerjen e kërkimit ligjor dhe përgatitjen e opinioneve me shkrim për çështje ligjore, materiale ose procedurale. Referuar procedurave për komandimin, rezulton se sipas nenit 54 të ligjit çdo institucion, nga ata të përcaktuar nga ligji, mund të kërkojë komandimin, dhe është Këshilli që shpall kërkesën për plotësimin e këtyre pozicioneve (pika 2). Pas aplikimit të magjistratit të interesuar, Këshilli vlerëson nëse komandimi është në përputhje me interesat e gjykatës ose prokurorisë ku ai ushtron funksionin, në rast të kundërt magjistrati përjashtohet nga kandidimi (pika 4). Më tej, institucioni vlerëson aplikimet dhe kërkon komandimin e magjistratit (pika 5) dhe është Këshilli ai që në përfundim të kësaj procedure merr vendimin, duke përcaktuar në vendim edhe kushtet e komandimit (pika 6). Edhe në rast të konfirmimit të komandimit të kërkuar nga institucionet ku magjistrati është komanduar (nenet 55 dhe 56), është Këshilli ai që ka kompetencën për të vendosur në lidhje me këtë. Sipas nenit 57 të ligjit afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur, dhe me kërkesë të magjistratit të komanduar Këshilli mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuara. Pas periudhës të komandimit magjistrati ka të drejtë që të kthehet në pozicionin e mëparshëm. Sipas nenit 58 të ligjit këshillat miratojnë rregulla të detajuara për komandimin, pasi kanë marrë mendimin e institucioneve ku komandohen magjistratët, për të siguruar që përvoja profesionale e tyre t'u shërbejë këtyre institucioneve.

61. Bazuar në interpretimin sistematik dhe logjik të dispozitave të sipërcituara, si dhe nisur nga qëllimi e kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, Gjykata vlerëson se instituti i komandimit të magjistratit përbën pjesë të zhvillimit të karrierës së tij, për rrjedhojë edhe gjatë kësaj periudhe magjistrati konsiderohet se nuk zhvishet nga statusi i tij. Ky përfundim gjen mbështetje edhe në parashikimin e pikës 1 të nenit 53, sipas së cilës komandimi duhet të jetë i pajtueshëm me mbajtjen e statutit të magjistratit. Pavarësisht funksionit që kryhen gjatë periudhës së komandimit, magjistrati gëzon të njëjtat të drejta dhe përfiton nga të njëjtat garanci si çdo magjistrat tjetër, përfshirë edhe ato që i garantohen gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor. Një qëndrim i ndryshëm bie ndesh jo vetëm me parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe atë të ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, por edhe me vetë jurisprudencën e kësaj Gjykate.

62. Gjykata ka theksuar se shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi, si dhe organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët, për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionit që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria. Gjyqtari, për shkak të funksionit që ka, trajtohet nga Kushtetuta si funksion kushtetues. Si i tillë, ai gëzon, përveç të tjerave, mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta. Kjo del qartë nga përmbajtja e dispozitës që parashikon shkarkimin e gjyqtarit, e cila është e ngjashme me atë të shkarkimit të zyrtarëve që ushtrojnë funksione të rëndësishme, duke përdorur të njëjtat standarde për këtë kategori funksionarësh shtetërorë (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

63. Gjykata rithekson se pavarësisht ndryshimeve kushtetuese, pjesë e paketës së reformës në drejtësi, mbrojtja e posaçme kushtetuese e gjyqtarit, me qëllim garantimin e pavarësisë së funksionit të tij, është ruajtur. Në të njëjtën frymë ajo vlerëson se shkon edhe përmbajtja e nenit 53 të ligjit nr. 96/2016 të kundërshtuar. Gjatë periudhës që magjistrati pranon të komandohet në një institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë, ai, pavarësisht garancive dhe statusit që gëzon, do t' nënshtrohet rregullave të veprimtarisë së punës së atij institucioni, duke gëzuar të drejtat, por edhe detyrimet që zbatohen për anëtarët e tij, përfshirë këtu edhe procedimin disiplinor sipas rregullave të posaçme që zbatohen për këta funksionarë. Sipas parashikimeve të pikës 12 të këtij neni në rastet e përgjegjësisë disiplinore, institucioni ku ai është komanduar ka të drejtën e propozimit të masës së shkarkimit, dhe

është magjistrati ai që vlerëson nëse do e referojë çështjen në Këshill. Në kuptim të kësaj dispozite është magjistrati ai që zgjedh nëse do të procedohet nga institucioni ku është komanduar apo nëse çështja e tij do të shqyrtohet nga Këshilli, rast në të cilin institucioni propozues zëvendëson ILD-në në procedurën disiplinore. Në thelb, përmbajtja e pikës 12 të nenit 53 nuk ndryshon kuptimin dhe qëllimin e procedimit disiplinor që kryhet KLGJ-ja, në kuptim të dispozitave vijuese të këtij ligji, dhe nuk e zhvesh magjistratin nga garancitë që i janë njohur atij në nivel kushtetues. Përgjegjësia disiplinore në kuptim të kësaj dispozite lidhet me shkeljet e parashikimeve ligjore që zbatohen për anëtarët e institucionit ku magjistrati komandohet, të kryera gjatë periudhës së emërimit në një pozicion jomagjistrati, dhe jo me shkeljet e atyre parashikimeve që lidhen me ushtrimin e detyrës së magjistratit, të cilat rregullohen në pjesën V të këtij ligji. Pavarësisht kësaj, institucioni nuk mundet të marrë me iniciativën e tij masën e shkarkimit të magjistratit, pasi sipas ligjit ai ka rolin e propozuesit dhe vetëm në raste përjashtimore, kur kjo vendoset me vullnetin e lirë të magjistratit, ai mund të vendosë në themel në lidhje me këtë masë. Por edhe në këto raste, sipas pikës 13 të këtij neni, institucioni në të cilin është komanduar magjistrati informon këshillin për çdo vendim të marrë dhe ankimi në gjykatë i këtij vendimi pezullon edhe zbatimin e tij. Për të gjitha argumentet e mësipërme Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar.

64. Në përfundim, për të gjitha arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve në lidhje me papajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitave të ligjit nr. 96/2016 duhet të rrëzohen si të pabazuara.

B.3. Për ligjin nr. 115/2016

B.3.1. Për juridiksionin e Gjykatës

65. Në lidhje me atë pjesë të kërkesës që i referohet nenit 7, pika 2, shkronjat "a" dhe "c"; nenit 59, pika 1; nenit 62, pikat 8 dhe 13; nenit 68, pika 6; nenit 76, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, Gjykata vëren se këto dispozita, që rregullojnë aspekte të organizimit dhe funksionimit të këshillave gjyqësorë, nuk kanë qenë objekt i kërkesës së datës 21.12.2016 të paraqitur nga një grup deputetësh të Kuvendit dhe të marrë në shqyrtim prej saj me vendimin nr. 41, datë 16.5.2017. Për sa më sipër, për sa kohë që këto dispozita nuk janë marrë më parë në shqyrtim dhe nuk është mbajtur asnjë qëndrim në lidhje me to, nuk ka asnjë pengesë që t'i nënshtrohen këtij gjykimi të kontrollit abstrakt të normës.

B.3.2. Për pretendimin e cenimit të parimit të hierarkisë së akteve ligjore

66. Kërkuesit pretendojnë se në lidhje me përmbajtjen e nenit 7, pika 2, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 115/2016, Kushtetuta jo pa kuptim ka heshtur në lidhje me kriterin vjetërsi në profesion për anëtarët gjyqtarë të këtij institucioni. Nga përmbajtja e nenit 147 të Kushtetutës konstatohet se atje ku ka dashur Kushtetuta e ka përcaktuar vetë kriterin vjetërsi. Kjo dispozitë kushtetuese ka përcaktuar kriterin 15 vjet përvojë pune në profesion për anëtarët jogjyqtarë të KLGJ-së, ndërkohë që jo pa kuptim ka heshtur në lidhje me këtë kriter për anëtarët gjyqtarë. Pra, nëse për anëtarin jogjyqtar është përcaktuar kriteri vjetërsi në Kushtetutë, përcaktimi i këtij kriteri për anëtarin gjyqtar nuk mund t'i lihet ligjit. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një rezervë kushtetuese. Në lidhje me parashikimin e kriterit për vlerësimin e performancës së anëtarit gjyqtar, duhet theksuar se përzgjedhja e anëtarëve të KLGJ-së nuk është një përzgjedhje profesionale, por e bazuar në vlerësimin subjektiv të gjyqtarëve që votojnë. Po ashtu, marrja e dy vlerësimeve profesionale kërkon kryerjen e detyrave si gjyqtar për një farë kohe përpara se t'i nënshtrohet vlerësimit, çka do të riaktivizonte kriterin e eksperiencës në punë. Sipas kërkuesve, ky parim cenohet edhe nga neni 59/1 i ligjit, i cili parashikon pozicionin e zëvendëskryetarit të KLGJ-së dhe kushtëzimin që ai të zgjidhet nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë, pasi ai vjen në kundërshtim të hapur me nenin 147/9 të Kushtetutës, duke tejkaluar përmbajtjen e kësaj dispozite.

67. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se për sa i përket nenit 7, pika 2, të ligjit, Kushtetuta në mënyrë të qartë përcakton se ligji mund të shtojë më shumë kritere për anëtarët e

KLGJ-së sesa ato të parashikuara në Kushtetutë. Vjetërsia si gjyqtar është qartësisht një kriter i tillë dhe jemi para rastit klasik të rezervës ligjore. E njëjta qasje është për të gjithë zyrtarët e lartë të sistemit të drejtësisë të parashikuar në Kushtetutë, e cila parashikon kriteret kryesore për personat që mbajnë këtë pozicion dhe autorizon ligjvënësin që të shtojë më shumë kritere. Bazuar edhe në përmbajtjen e nenit 147, pika 3, të Kushtetutës, është detyrë e ligjvënësit të gjejë një mënyrë praktike për të zbatuar këtë parashikim të qartë dhe të drejtpërdrejtë kushtetues. Në lidhje me pretendimin e kërkuesve për nenin 59, pika 1, Kushtetuta nuk e parashikon pozicionin e zëvendëskryetarit të KLGJ-së, prandaj ajo nuk mund të rregullojë kritere për zgjedhjen e tij. Nga ana tjetër, të parashikosh zëvendësuesit e të gjitha pozicioneve është një domosdoshmëri dhe praktikë e mirë në teorinë dhe praktikën organizative.

68. Gjykata vëren se në nenin 4, si dhe në preambulën e Kushtetutës deklarohet parimi i shtetit të së drejtës, i cili është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai është një normë e pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përftuar kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër *(shih vendimin nr. 55, datë 27.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

69. Neni 4, pika 3, i Kushtetutës parashikon se dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përjashtimi kushtetues i parashikuar në këtë dispozitë nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave. Por rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të detajuara ose shteruese. Megjithëse disa çështje lidhur me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra, Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore e politike të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Shpesh, Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore. Përveç kësaj, ajo mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet për të cilat nuk mund t'i lerë hapësira rregullimi ligjvënësit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 2, datë 18.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

70. Gjykata vëren se sipas nenit 147, pika 2, të Kushtetutës, KLGJ-ja përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe 5 nga Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Sipas pikës 3 të tij: "*Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në*

profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.".

71. Në përputhje me parashikimin kushtetues, në nenin 7 të ligjit nr. 115/2016 parashikohet mënyra e përzgjedhjes dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët gjyqtarë për anëtarë të KLGJ-së. Në pikën 1 të këtij neni parashikohet raporti që duhet të ruhet mes niveleve të ndryshme të gjyqësorit, kurse në pikën 2 parashikohen kushtet për të kandiduar, mes të cilave: "në kohën e kandidimit të kenë ushtruar funksionin e gjyqtarit për të paktën 10 vjet" (shkronja "a"); "të jenë vlerësuar të paktën "shumë mirë" në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale" (shkronja "c") etj.

72. Në lidhje me pretendimin e kërkuesve se përmbajtja e nenit 7, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 115/2016 bie ndesh me parimin e hierarkisë së akteve ligjore, Gjykata vëren se nuk u formua shumica e kërkuar prej 5 votash, ndaj në kuptim të pikës 4 të nenit 73 të ligjit nr. 8577/2000, ai konsiderohet i rrëzuar. [2]

73. Kurse për sa i takon pretendimit në lidhje me shkronjën "c" të po këtij neni, Gjykata vlerëson se ai është i pabazuar, pasi është vetë norma kushtetuese që i ka deleguar ligjvënësit përcaktimin e kritereve të tjera, përtej atyre kushtetuese, si dhe rregullat për përzgjedhjen e anëtarëve të KLGJ-së. Në rastin konkret ligjvënësi në miratimin e kësaj dispozite ka vepruar në përputhje me rezervën ligjore absolute të parashikuar nga neni 147, pika 3, i Kushtetutës, pasi është vetë norma kushtetuese që i ka rezervuar ligjit rregullimin e kësaj çështjeje konkrete.

74. Kërkuesit pretendojnë se parimi i hierarkisë së akteve ligjore cenohet edhe nga përmbajtja e nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 115/2016, që parashikon zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLGJ-së nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë. Gjykata vëren se sipas nenit 147, pika 9 të Kushtetutës, kryetari i KLGJ-së zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë, sipas ligjit. Edhe pse norma kushtetuese nuk ka parashikuar funksionin e zëvendëskryetarit të Këshillit, ai parashikohet në Kreun II të ligjit, që rregullon organizimin dhe mbledhjen e KLGJ-së. Në lidhje me mënyrën e zgjedhjes së zëvendëskryetarit në nenin 59, pika 1, të ligjit është parashikuar: "*Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhen në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve. Ata qëndrojnë në detyrë deri në përfundim të mandatit si anëtarë të Këshillit.*". Në pikën 3 të nenit 59 janë parashikuar kompetencat që ushtron kryetari i Këshillit, kurse sipas nenit 60 të ligjit zëvendëskryetarit i njihen të gjitha kompetencat që parashikohen për kryetarin, të cilat ai i ushtron në mungesë dhe në pamundësi të këtij të fundit, si dhe në rastet e pamundësisë së përkohshme.

75. Gjykata vëren se sipas nenit 6 të Kushtetutës organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur ajo parashikon ndryshe. Kurse neni 81, pika 2, i Kushtetutës i ka njohur ligjvënësit të drejtën që të miratojë ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga vetë ajo. Në kuptim të këtyre dispozitave Gjykata vlerëson se vetë Kushtetuta ia ka nënshtruar rezervës ligjore absolute çështjen e organizimit dhe të funksionimit të organeve dhe institucioneve të parashikuara prej saj, duke i dhënë ligjvënësit hapësirën për të rregulluar këto çështje. Edhe pse funksioni i zëvendëskryetarit nuk është parashikuar si i tillë nga norma kushtetuese, për sa kohë që ai përbën një aspekt të organizimit dhe funksionimit të KLGJ-së, parashikimi i tij si i tillë, mënyra se si do të rregullohet zgjedhja e tij, si edhe funksionet që do të ushtrojë janë çështje që i janë njohur për rregullim ligjvënësit të zakonshëm. Për rrjedhojë edhe ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar.

B.3.3. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për punë

76. Sipas kërkuesve, neni 7, pika 2, shkronjat "a" dhe "c", cenojnë të drejtën për të zgjedhur një

[2] Votuan pro pranimit të këtij pretendimi gjyqtarët: Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo. Votuan kundër gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj dhe Fatmir Hoxha.

vend pune, dhe konkretisht për të konkurruar për t'u zgjedhur anëtar i KLGJ-së, duke qenë se Kushtetuta nuk e ka kushtëzuar të drejtën për të konkurruar me ndonjë afat, por thjesht me pjesëmarrjen proporcionale sipas shkallëve të gjykimit dhe nuk e lidh me pasjen e një vjetërsie pune. Gjithashtu, neni 59/1 ndalon anëtarët gjyqtarë në KLGJ që të konkurrojnë për t'u zgjedhur në vendin e punës si zëvendëskryetar.

77. Gjykata ka theksuar se e drejta për punë, sipas nenit 49, pika 1 të Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për të punuar përkufizohet nga GJEDNJ-ja si: "zgjedhja e një profesioni, e një vendi për të punuar dhe e sistemit të kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, sikurse parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit në kuptimin që ai i kushtohet një aktiviteti për të siguruar mjetet e jetesës (...) E drejta për të punuar dhe liria e profesionit nënkuptojnë çdo veprimtari të ligjshme që sjell të ardhura dhe që nuk ka një afat kohor të përcaktuar, me përjashtim të rasteve kur ka një rregullim të veçantë ligjor. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja direkte që pengojnë aktivitetin profesional është një shkelje e kësaj lirie për të vepruar. Garancia që Kushtetuta i jep një individi në lidhje me të drejtën për të punuar dhe lirinë e zgjedhjes së profesionit ka për qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e pajustifikuara të vendosura nga shteti" (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

78. E drejta për ushtrimin e një profesioni mund të kufizohet nga rregullime të arsyeshme që mund t'u atribuohen konsideratave të së mirës së përgjithshme. Liria për të zgjedhur një profesion, megjithatë, mund të kufizohet vetëm për hir të një interesi publik detyrues. Pra, nëse pas një shqyrtimi të kujdesshëm ligjvënësi vendos se një interes i përgjithshëm duhet mbrojtur, atëherë ai mund të vendosë kufizime për ta mbrojtur atë interes, por vetëm deri në atë nivel që mbrojtja nuk mund të realizohet nga një kufizim më i lehtë i lirisë për të zgjedhur. Në rastin kur cenimi i së drejtës për të zgjedhur një punë është i paevitueshëm, ligjvënësi duhet të përdorë gjithmonë mjetet rregulluese më pak kufizuese ndaj së drejtës themelore. Nëse ligjvënësi e kushtëzon të drejtën për të nisur një aktivitet profesional me përmbushjen e disa kritereve të caktuara, duke cenuar kështu të drejtën për të zgjedhur një profesion, në këtë rast rregullimet për të mirën e përgjithshme janë të legjitimuara. Por, këto kufizime duhen bërë vetëm kur veprime të tilla janë absolutisht të nevojshme për të mbrojtur në veçanti interesa të rëndësishëm të komunitetit dhe duhet që në të gjitha këto raste masa kufizuese e përzgjedhur të përmbajë cenimin më të vogël të mundshëm (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

79. Edhe pse kërkuesit pretendojnë cenimin e nenit 49 të Kushtetutës, ata nuk kanë arritur të argumentojnë se parashikimi i kritereve ligjore për të kandiduar si anëtar i KLGJ-së përbën cenim të këtij parimi. Sipas pikës 1 të nenit 136/a të Kushtetutës gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga KLGJ-ja pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe kryerjes së procesit të verifikimit paraprak sipas ligjit. Kurse sipas pikës 2 të këtij neni, kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin parashikohen me ligj. Sipas nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, shtetasi që fiton statusin e magjistratit sipas ligjit e gëzon atë sapo emërohet në funksion dhe e përfundon me mbarimin e ushtrimit të funksionit, për ndonjë nga shkaqet e parashikuara nga dispozitat ligjore. Në këtë kuptim, magjistratit që ka fituar këtë status, pasi ka plotësuar kriteret ligjore, i është garantuar e drejta për të zgjedhur profesionin dhe vendin e punës, si dhe për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme. Parashikimi i kritereve ligjore për kandidimin për një funksion tjetër brenda sistemit gjyqësor apo edhe vendosja e kufizimeve në këtë drejtim nuk mund të pranohen si argumente për të justifikuar cenimin e nenit 49 të Kushtetutës. Për

rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar.

B.3.4. Për pretendimin e cenimit të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor

80. Kërkuesit pretendojnë se neni 59, pika 1, i ligjit, në kundërshtim të hapur me nenin 147, pika 9, të Kushtetutës, ka parashikuar pozicionin e zëvendëskryetarit të Këshillit dhe kushtëzimin që ai të zgjidhet nga anëtarët jogjyqtarë, duke dobësuar në këtë mënyrë rolin e anëtarëve gjyqtarë në KLGJ. Gjithashtu, kjo dispozitë u mohon të drejtën anëtarëve gjyqtarë për të konkurruar dhe për t'u zgjedhur në pozicionin e zëvendëskryetarit të KLGJ-së. Ky përcaktim cenon edhe parimin e barazisë përpara ligjit, parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjyqtarët diskriminohen në raport me anëtarët e tjerë jogjyqtarë pa arsye objektive dhe të përligjura. Më tej, sipas kërkuesve, parashikimi në nenin 62, pikat 8 dhe 13, për përbërjen e disa prej komisioneve të KLGJ-së me shumicë anëtarësh jogjyqtarë, bie në kundërshtim me nenin 147 të Kushtetutës, i cili parashikon se KLGJ-ja vepron me shumicë gjyqtarë, raport që duhet të ruhet edhe në komisionet e përhershme e të përkohshme. Po ashtu, përmbajtja e nenit 68, pika 6, i cili parashikon se në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit, që është gjithmonë anëtar jogjyqtar, ka përparësi, bën që KLGJ-ja t'i marrë vendimet në mbledhjen plenare jo nga një shumicë gjyqtarësh, por nga anëtarët jogjyqtarë edhe për çështje që janë përcaktuese për statusin e gjyqtarëve, çka bie në kundërshtim të hapur me nenet 4, 116 dhe 147 të Kushtetutës. Në rastet kur anëtarët e KLGJ-së nuk marrin një votim me shumicë, por dalin barazim për sa i përket votimit për një procedim disiplinor të gjyqtarëve, si fakti, ashtu dhe fajësia e gjyqtarit në këtë procedim është e dyshimtë, për rrjedhojë ky dyshim duhet të shkojë në favor të gjyqtarit. Sipas tyre, jokushtetuese është edhe përmbajtja e nenit 76, pika 2, që i ka lënë kompetencën për të vendosur përjashtimin e një anëtari të organit kolegjial një organi monokratik sikurse është kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët jogjyqtarë. Kompetenca e përjashtimit të anëtarëve duhet të jetë kompetencë ekskluzive e mbledhjes plenare, në të kundërt mund të ndodhë që kryetari në mënyrë abuzive të pranojë kërkesën për përjashtim të një prej anëtarëve gjyqtarë dhe KLGJ-ja të vendoset nën kontrollin e plotë të dy pushteteve të tjera. Duke qenë se këto dispozita cenojnë parimin e ndarjes së pushteteve, ato cenojnë edhe parimin e pavarësisë së gjyqësorit në të gjithë komponentët e saj.

81. Sipas subjektit të interesuar, në lidhje me pretendimin për parashikimin e nenit 59, pika 1, të ligjit, zëvendëskryetari nuk është një funksionar me kompetenca të ndryshme nga ato të kryetarit. Përkundrazi, ai duhet të ushtrojë të njëjtat kompetenca si kryetari sa herë që ky i fundit nuk është në gjendje të bëjë detyrat e tij. Nëse vendimi politik i kushtetutëbërësit ka qenë që kryetari i KLGJ-së të jetë nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë, atëherë edhe zëvendësuesi i tij duhet të ketë të njëjtat karakteristika të zyrtarit që zëvendëson. Në lidhje me nenin 62, pikat 8 dhe 13, Kushtetuta parashikon ekzistencën e këtyre komisioneve, por në asnjë rast nuk përcakton përbërjen apo mënyrën e funksionimit, duke ia deleguar këtë çështje shprehimisht ligjvënësit. Përbërja me shumicë anëtarësh gjyqtarë është ruajtur pikërisht në ato komisione që kanë të bëjnë thelbësisht me çështje të karrierës së gjyqtarëve. Për sa i përket parashikimit të nenit 68, pika 6, që parashikon votën përcaktuese të kryetarit, kjo dispozitë bazohet në rekomandimin e Komisionit të Venecias. Pretendimi në lidhje me nenin 76, pika 2, se anëtarët gjyqtarë kanë prirje më të madhe për të qenë në konflikt interesi, nuk ka themel dhe as vërtetësi, pasi edhe anëtarët jogjyqtarë mund të kenë shprehur mendimet e tyre për çështje në cilësinë e tyre si avokatë, ekspertë, inspektorë etj. përderisa janë juristë.

82. Bazuar në parimin *iura novit curia*, Gjykata rithekson se ajo ka në kompetencë të vlerësojë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj. Në këtë kuptim, Gjykata në rastin konkret çmon se pavarësisht cilësimit që iu është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesit, ato do të vlerësohen në këndvështrim të respektimit të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe atij të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

83. Gjykata rithekson rëndësinë thelbësore të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve si një

element i shtetit të së drejtës. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve, si një nga bazat kryesore të shumë kushtetutave moderne, i parashikuar edhe në nenin 7 të Kushtetutës, u jep mundësi të tria degëve të qeverisjes (legjislativit, ekzekutivit e gjyqësorit) jo vetëm të respektojnë njëra-tjetrën në ushtrimin e funksioneve të tyre, por edhe të kontrollohen e ndihmohen në mënyrë të ndërsjellë, me qëllim funksionimin sa më mirë të sistemit të qeverisjes. Ky parim ndihmon që pushteti të shpërndahet në disa mbajtës me funksione e detyra të ndryshme për të siguruar reciprokisht një drejtësi më të madhe në ushtrimin e tij. Nga ana tjetër, parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve ndihmon, gjithashtu, edhe në bashkëveprimin e mbajtësve të pushteteve, duke siguruar shkallë garancie dhe siguri më të lartë në marrjen e vendimeve të drejta dhe të peshuara. Prandaj, parimi i ndarjes e balancimit të pushteteve, pavarësisht nga alternimi i forcave politike në pushtet, duhet të mbetet mbizotërues (*shih vendimin nr. 16, datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

84. Gjykata ka theksuar se parashikimet kushtetuese për ndarjen e pushteteve në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, për pavarësinë, paanshmërinë dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve, për sanksionimin në ligje organike të organizimit të gjykatave dhe kompetencat e tyre në procedurat gjyqësore, përkufizojnë statusin kushtetues të gjyqtarëve, si dhe pozicionojnë drejtësinë si një degë të mëvetësishme të pushtetit, të pavarur dhe të paanshme. Parimet e mësipërme kushtetuese gjejnë shprehjen e tyre më të drejtpërdrejtë në nenin 145, pika 1, të Kushtetutës, ku deklarohet se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Roli i gjyqtarëve dhe gjykatave në një shtet të së drejtës është që ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Në kuadrin e parimit të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, varësia absolute e gjyqtarit ndaj ligjit është kushti dhe legjitimimi i kësaj pavarësie (*shih vendimin nr. 16, datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

85. Referuar ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, Gjykata vëren se kushtetutëbërësi e ka konceptuar KLGJ-në si organin që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Gjykata rithekson se sipas nenit 147, pika 2, të Kushtetutës, KLGJ-ja përbëhet nga 11 anëtarë, 6 prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe 5 i zgjedh Kuvendi nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Për sa i përket mënyrës së organizimit dhe funksionimit të këtij organi, është ligji që ka parashikuar parimet dhe rregullat për këtë qëllim. Në kreun II të ligjit nr. 115/2016 rregullohen aspektet e organizimit dhe të mbledhjes së KLGJ-së. Sipas nenit 59, pika 1 të ligjit kryetari dhe zëvendëskryetari i KLGJ-së zgjidhen nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë me shumicën e thjeshtë të votave të këshillit. Në lidhje me kompetencat që ushtron secili nga këta funksionarë, rezulton se kryetari, sipas pikës 3 të nenit 59: a) është përgjegjës për mirëfunksionimin e Këshillit dhe zbatimin me eficiencë të detyrave të tij, në përputhje me ligjin; b) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjen e Këshillit; c) mbikëqyr dhe drejton administratën e Këshillit; ç) përfaqëson Këshillin në marrëdhëniet me të tretët; d) siguron bashkëpunimin me institucionet e tjera; dh) raporton para Kuvendit për gjendjen në sistemin gjyqësor dhe merr masat për publikimin e raportit; e) propozon kryetarët e komisioneve të përhershme dhe cakton kryetarët e komisioneve të përkohshme të Këshillit; ë) ushtron çdo detyrë tjetër që i jepet me ligj. Sipas nenit 62, pika 6, komisionet zgjedhin kryetarët përkatës në mbledhjen e tyre të parë me shumicë votash dhe bazuar në propozimin e kryetarit të KLGJ-së, i cili është kryetar i komisioneve ku ai merr pjesë. Sipas nenit 67, pika 1, kryetari i KLGJ-së vendos rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit, kurse sipas nenit 68, pika 2, kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese. Në rastin e paraqitjes së kërkesës për heqje dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare të Këshillit, sipas nenit 75, pika 2 vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga kryetari i KLGJ-së, kurse në rast se dorëheqjen e jep kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari i Këshillit. I njëjti rregull gjen zbatim edhe në rastet e kërkesës për përjashtimin e anëtarit, sipas pikës 2 të nenit 76. Kurse në lidhje me kompetencat e zëvendëskryetarit, në nenin 60 të ligjit parashikohet se ai ushtron të gjitha kompetencat që

i njihen kryetarit në rast mungese apo pamundësisë së këtij të fundit.

86. Sipas parashikimeve të nenit 147 të Kushtetutës, të ndryshuar, kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë. Ai ka kompetencën për të drejtuar Këshillin, si dhe ushtron çdo kompetencë tjetër me natyrë administrative. Gjykata vëren se parashikimi kushtetues për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë gjen pasqyrim në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 115/2016 si për kryetarin, ashtu edhe për zëvendëskryetarin e këtij organi. Siç vërehet nga përmbajtja e dispozitave të sipërcituara, zëvendëskryetarit të KLGJ-së, edhe pse është parashikuar si funksion më vete, ligji nuk i ka njohur në thelb kompetenca të ndryshme nga ato që ushtron kryetari apo kompetenca të tjera që lidhen me çështje të organizimit dhe të funksionimit të KLGJ-së. Sipas nenit 60 të ligjit zëvendëskryetari ushtron të gjitha kompetencat e kryetarit, por vetëm në mungesë dhe në pamundësi të këtij të fundit, si dhe në rastet e pamundësisë së përkohshme të tij. Nisur nga kjo premisë, Gjykata vlerëson se përzgjedhja e zëvendëskryetarit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë nuk përbën cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe nuk dobëson rolin e anëtarëve gjyqtarë në Këshill. Po ashtu, Gjykata vëren se fryma e kushtetutëbërësit ka qenë që ky organ të drejtohet nga një funksionar i zgjedhur nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë të tij. Për rrjedhojë, edhe parashikimi ligjor për mënyrën se si do të zgjidhet zëvendëskryetari i këtij organi përputhet me vullnetin e kushtetutëbërësit për mënyrën se si ai e ka konceptuar dhe organizuar këtë organ kushtetues. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar.

87. Kërkuesit kanë pretenduar se ky parim cenohet edhe nga përmbajtja e nenit 62, pikat 8 dhe 13, ku parashikohet formula e përbërjes për disa nga komisionet e përhershme të KLGJ-së, pasi nuk respektohet parimi i përbërjes së tyre me shumicë anëtarësh, sipas nenit 147 të Kushtetutës.

88. Gjykata vëren se në nenin 147/a të Kushtetutës janë parashikuar kompetencat e KLGJ-së dhe në pikën 2 të këtij neni përcaktohet se ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit. Bazuar në nenin 62, pika 3, të ligjit, komisionet e përhershme të KLGJ-së janë: Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit; Komisioni Disiplinor; Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale; Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Këto komisione përbëhen nga tre anëtarë dhe pranë çdo komisioni caktohen edhe dy anëtarë zëvendësues. Sipas pikës 4 të këtij neni, caktimi i anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të komisioneve bëhet duke mbajtur parasysh nevojën për të garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës dhe respektimin e kërkesave dhe të raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë, dhe, për aq sa është e mundur, preferencat e tyre. Në lidhje me përbërjen e komisioneve të përhershme rezulton se: Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit përbëhet nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar (pika 8); Komisioni Disiplinor përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar (pika 9); Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar (pika 10); Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar (pika 11).

89. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se për sa i takon përbërjes së komisioneve të përhershme, në tre prej tyre është ruajtur raporti mes shumicës dhe pakicës së anëtarëve në Këshill, ndërkohë që Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit përbëhet nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Gjykata vëren se edhe pse ligji nuk ka përcaktuar kompetencat e këtij komisioni dhe çështjet për të cilat ai ka të drejtë të vendosë, sipas nenit 147/a, pika 1, shkronja "dh", të Kushtetutës është vetë Këshilli që propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave, kompetenca për të cilat Gjykata në vendimin e saj nr. 41, datë 16.5.2017 ka vlerësuar se duhet të reflektohen edhe në miratimin e dispozitave të reja ligjore të ligjit nr. 115/2016.

90. Përveç komisioneve të përhershme ligji ka parashikuar edhe ngritjen e komisioneve të përkohshme. Sipas nenit 62, pika 13, për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të ILD-së për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e kryetarit të Këshillit dhe këto vendime janë përfundimtare dhe nuk mund të apelohen para

mbledhjes plenare të Këshillit. Megjithatë, Gjykata vlerëson se këto vendime nuk vendosin në mënyrë përfundimtare në lidhje me masat disiplinore, të cilat, në kuptim të nenit 147/a të Kushtetutës, janë kompetencë ekskluzive e KLGJ-së. Gjykata ka theksuar se si komisionet e përhershme, edhe ato të përkohshme janë organizma ndihmës në varësi të KLGJ-së dhe si të tillë nuk mund të ushtrojnë atributet që Kushtetuta ia ka njohur në mënyrë të shprehur kësaj të fundit (*shih vendimin nr. 41, datë 16.5.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

91. Për sa më sipër, duke pasur parasysh kompetencat që Kushtetuta i ka njohur KLGJ-së, kompetencat që me ligj u janë njohur komisioneve të përhershme dhe të përkohshme të këtij organi, si dhe në linjë me jurisprudencën dhe qëndrimin e saj të mbajtur në vendimin nr. 41, datë 16.5.2017, Gjykata vlerëson se raporti i anëtarësisë në këto komisione nuk konsiderohet se cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor, ndaj edhe ky pretendim është i pabazuar.

92. Kërkuesit kanë pretenduar se parimi i ndarjes dhe i balancimit ndërmjet pushteteve, si dhe parimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor cenohet edhe nga përmbajtja e nenit 68, pika 6, të ligjit, sipas të cilit kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese. Në lidhje me këtë pretendim nuk u formua shumica e kërkuar prej 5 votash, ndaj në kuptim të pikës 4 të nenit 73 të ligjit nr. 8577/2000, ai konsiderohet i rrëzuar.[3]

93. Në lidhje me pretendimet për papajtueshmërinë me Kushtetutën të përmbajtjes së nenit 76, pika 2, të ligjit nr. 115/2015, Gjykata vëren se në nenin 75 të ligjit parashikohen rastet e dorëheqjes të anëtarit të KLGJ-së nga pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve ose në mbledhjen plenare, ndërsa në nenin 76, pika 1, parashikohet se gjyqtari ose nëpunësi civil i proceduar, ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Këshillit nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës administrative vetëm në fazën paraprake të procesit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 dhe ai nuk ka hequr dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes. Në pikën 2 të nenit 76 parashikohet se vendimi për përjashtimin e anëtarit merret nga kryetari i Këshillit, kurse kur kërkohet përjashtimi i këtij të fundit vendimi merret nga zëvendëskryetari.

94. Gjykata rithekson se KLGJ-ja është konceptuar si një organ kolegjial i vetëqeverisjes së pushtetit gjyqësor, me qëllim garantimin e pavarësisë dhe mbarëvajtjes së tij. Në përputhje me parimin e kolegjialitetit janë parashikuar në ligj edhe kompetencat që ushtron ky organ, si edhe mënyra e funksionimit dhe organizimit të tij. Duke qenë se kompetenca për të vendosur në lidhje me kërkesën për përjashtim, pra në lidhje me pjesëmarrjen ose jo të anëtarit të Këshillit në shqyrtimin e procedurës administrative, lidhet në mënyrë të drejtë me kompetencat funksionale të këtij organi, ajo nuk mund të ushtrohet nga një organ tjetër, siç është kryetari apo zëvendëskryetari. Vlerësimi dhe vendimmarrja në lidhje me kërkesën për përjashtim nuk mund të lihet në kompetencë të kryetarit, i cili ka funksione administrative të mirëpërcaktuara dhe kjo çështje, në kuptim të përmbajtjes së dispozitave të këtij ligji, del tej fushës së tij të kompetencave. Po ashtu, parashikimi se në rastet e paraqitjes së kërkesës për përjashtim për kryetarin vendos zëvendëskryetari, përbën një kompetencë shtesë që i njihet nga ligji këtij të fundit, i cili, siç u theksua më sipër, është parashikuar si funksion më vete vetëm me qëllim moskrijimin e boshllëqeve në institucion në rastet e mungesës apo pamundësisë së kryetarit për të ushtruar funksionet e tij. Për rrjedhojë, parashikimi i kësaj dispozite krijon dyshime në lidhje me respektimin e parimit të ruajtjes së pavarësisë së pushtetit gjyqësor, ndaj ky pretendim është i bazuar dhe duhet të pranohet.

95. Në përfundim, për të gjitha arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve në lidhje me papajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitave të ligjit nr. 115/2016 duhet të pranohen pjesërisht, vetëm në lidhje me përmbajtjen e nenit 76, pika 2, të këtij ligji.

---

[3] Votuan pro pranimit të këtij pretendimi gjyqtarët: Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo. Votuan kundër gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vitore Tusha dhe Altina Xhoxhaj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/a dhe 134/1/h të Kushtetutës, si dhe të neneve 49/3/d, 51, 51/a, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 76, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera për shfuqizimin e dispozitave të ligjeve nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj